



Nëse për Pirandello-n mundimet e dashurisë ishin “mizore”, nuk ishin më të pakta mundimet që hoqi Zefi. Vasha që u bë shkak i vuajtjeve të tij mbante të njëjtin emër me të fejuarën e mikut: ajo si për ironi të fatit quhej *Lina Pirandello*. Skiro kishte rënë në dashuri me motrën e madhe të Luigjit, Linën, bashkëmoshatare më të, dhe kishte ushqyer shpresën ta bënte për vete, duke i kërkuar ndihmë mikut, të cilit i kishte hapur zemrën «një natë të paharrueshme».

“Tregtia e madhe e letrave” që Luigji Pirandello i shkroi Zef Skiroit

Nga Matteo Mandalà



“BUZUKU” DHE
ABDULLAH ZENELI
DEKOROHEN ME
TITULLIN “NAIM
FRASHËRI”

(fq. 5)

PANAIRI I LIBRIT
“TIRANA 2020”
DO TË ZHVILLOHET
ONLINE

SHËNIME PËR LIBRAT

STEFAN ÇAPALIKU
“IMAGO & VERBUM”

Nga Ferid Hudhri

(fq. 5)

ATË GJERGJ FISHTA
“Hajrija”

Nga Zef Zorba

(fq. 10)

RIDVAN DIBRA
“Legjenda e vetmisë”

nga Ismet Aliu

(fq. 8)



VIKAMAT E TINGUJVE TË FEIM IBRAHIMIT

Nga Enver Kushi

(fq. 8)

Libri i Vera Ibrahimit, i kalon caqet e një libri thjesht kujtimesh. Ai i ka të gjitha: edhe kronikën e jetës, edhe kujtimet, edhe të përditshmen, botën artistike shqiptare me arritjet e padiskutueshme, por edhe me provincializmin, mediokritetin, ligësitë vulgaritetin e kohës që lamë pas, edhe anatominë e procesit krijues ose laboratorin e kompozitorit të madh Feim Ibrahimit... Ajo njeh mirë edhe muzikën, duke zbërthyer estetikisht, me profesionalizëm, veprat muzikore të bashkëshortit të saj.

ZOJA E SHKODRËS NË DY POEZI

(fq. 11)

WILLIAM FAULKNER
Një fjalë për
shkrimtarët e rinj



(fq. 18)

BIBLIOTEKË

Louise Glück

(fq. 12)

Zambak të argjendtë

Ernest Hemingway

(fq. 15)

*Një vend i pastër, i
ndriçuar mirë*

Rexhep Ferri

(fq. 14)

Rrëfimi i fatit të keq

Ndëshkimi i një
kryevepre të letërsisë
botërore nga
keqpërkthimi

Nga Theodor Cico


(fq. 16)



“Tregtia e madhe e letrave” që Luigji Pirandello i shkroi Zef Skiroit

Nga Matteo Mandalà

Sasia e madhe e dokumenteve, më së shumti të pabotuara, që kanë dalë në dritë këto dhjetëvjeçarët e fundit, na lejon të njohim më mirë veprimtarinë letrare që zhvilloi Zef Skiroi gjatë periudhës rinore, sidomos gjatë viteve '80 të shek. XIX, që ishin ndër më të rëndësishmet e krijimtarisë së tij. Mes këtyre dokumenteve rëndësi të veçantë paraqesin letrat që ndër vitet 1886-1890 i dërgoi Luigji Pirandello, sepse këto japin një ndihmesë, shpeshherë vendimtare, qoftë në rindërtimin e kuadrit historik e kulturor palermitan në të cilin u ngjizën veprat rinore të poetit arbëresh, qoftë në qëmtimin e elementeve biografike private, marrëdhënieve shoqërore dhe ndjenjave që e nxitën dhe e frymëzuan. Po aq të rëndësishme janë këto letra për Pirandello-n: nga njëra anë ato ndihmojnë në rindërtimin e njërës prej përvojave më interesante që përjetoi shkrimtari dhe dramaturgu i shquar italian gjatë periudhës së miqësisë së ngushtë me Zef Skiroin. Nga ana tjetër, këto letra japin dorë për një shqyrtim kritik më të thellë e më të kujdesshëm të krijimtarisë së gjerë rinore të Pirandello-s, një pjesë e mirë e së cilës i përket pikërisht periudhës kur banonte në Palermo. Pa kuptuar drejt vlerën që pati ajo periudhë rinore për jetën private dhe publike të Pirandello-s, që i la mbresa aq të thella sa e bëri të piqej para kohe, ndoshta Leonardo Sciascia nuk do të kishte shkruar se «pa aventurën e sqfurit nuk do të kishte qenë as aventura e të shkruarit e të rrëfyerit», ndërsa Andrea Camilleri nuk do t'i kishte vënë librit të tij, kushtuar



Pirandello-s, titullin “*Biografia e një biri të ndryshuar*”. Në këto shënime të shkurtra do të lëmë mënjanë ato pjesë të letërkëmbimit që hedhin dritë mbi zhvillimet artistike të dy miqve në periudhën kyçe të formimit të tyre rinor, pasi do të përqendrojmë vëmendjen vetëm në disa momente njerëzore dhe intelektuale të marrëdhënies së tyre, duke e lënë për një rast tjetër thellimin e aspekteve mirëfilli letrare.

Pirandello njihet me Skiroin aty nga viti 1882, kur u transferua bashkë me familjen në Palermo, ku prej disa vitesh ishte vendosur Zefi. Prej asaj kohe dy të rinjtë lidhën një miqësi të ngushtë dhe të sinqertë, që ushqej, përveçse nga një vlerësim i ndërsjellë, edhe nga interesa e aspirata të përbashkëta artistike dhe letrare. Deri pas vitit 1890 kur marrëdhëniet mes tyre u ftohën, Pirandello dhe Skiro mbajtën një letërkëmbim të rregullt, prej të cilit na ka mbërritur vetëm një pjesë e letrave që ata i shkruan njëri-tjetrit. *Korpusi* i letërkëmbimit, përveç letrave që kemi në dorë, duhej të përmbante medoemos edhe të tjera që kanë humbur. Nuk dimë asgjë mbi letrat që Skiroi i shkroi Pirandello-s. Deri më sot njihen vetëm letrat që Pirandello u shkroi familjarëve dhe miqve. Megjithëse ka shumë të ngjarë që Pirandello të mos i ketë ruajtur letrat e Skiroit, nuk përjashtohet që ato të gjenden diku në ndonjë arkiv privat. Botimi i plotë i letrave i përket vitit 2002 (shih *Peppino mio: lettere di Luigi Pirandello a Giuseppe Schirò (1886-1890)*, a cura di Antonino Perniciaro, Filomena Capobianco, Cristina Iacono, con un saggio introduttivo di Matteo Mandalà, Biblioteca museo Pirandello di Agrigento, 2002), pas një botimi të pjesshëm dhe të cungët të vitit 1994 (Luigi Pirandello, *Amicizia mia. Lettere inedite al poeta Giuseppe Schirò (1886-1887)*, a cura di A. Armati, A. Barbina, Istituto di studi pirandelliani. Quaderni 9, Bulzoni, Roma, 1994).

Pirandello qëndroi në Palermo gjatë viteve 1882-1887. Skiroin, me gjasa do ta ketë takuar korridoreve të liceut klasik “Vittorio Emanuele II” të Palermos: Skiroi, dy vjet më i madh, e mbaroi liceun në vitin 1884, ndërkohë që Pirandello ishte ende në vitin e dytë. Këtyre viteve u përkasin sprovat e para letrare. Shtatëmbëdhjetëvjeçari Luigji në vitet 1884-1885 botoi tregimet e para. Nga ana e tij Zefi, mes viteve 1882 dhe 1885 botoi disa lirika italisht në *La Nuova Età* e më vonë, në vitin 1885, falë interesimit të kushërirës Cristina Gentile Mandalà, botoi disa poezi te *Fiamuri Arbërit*, që ishte themeluar e drejtuar nga De Rada. Këto sprova të para letrare i bashkojnë dy të rinjtë dhe u hapin rrugën veprave të mëpasme.

Dy të rinjtë nuk takoheshin vetëm në shkollë. Familja e

Pirandello-s fillimisht u vendos me banim në rrugën *Porta di Castro*, pranë Pallatit Mbretëror të Normanëve, e pas një viti u transferua në lagjen *Borgo*, pranë *Foro Italico*, në një apartament që gjendej përballë kishës së Shën Luçisë; ndërsa familja e Skiroit u vendos në rrugën *Porrazzi*, që gjendej në krah të *Corso Vittorio Emanuele*. Pra të dy banonin në qendër të qytetit, fare pranë liceut, por edhe pranë bibliotekës publike Vittorio Emanuele, që të dy e frekuentonin rregullisht. Gjatë kësaj periudhe Pirandello shkonte shpesh edhe në shtëpinë e Skiroit, ku të dy bashkë ushtroheshin në artin e vargëzimit. Me siguri Pirandello njihte edhe vëllanë e Skiroit, sepse e përmend në letrën e tetorit 1887.

Kjo nuk ishte një shoqëri e rastit, por një miqësi e qëndrueshme, që u forcua falë takimeve të shpeshta, interesave dhe shqetësimeve të përbashkëta e madje edhe falë dashurive të para. Skena ideale e kësaj miqësie ishte Palermo, «qyteti i nismave taraskoniane», sikundër do ta quajë Pirandello në letrën që i dërgon më 27 gusht 1887 mikut Carmelo Faraci, i lumtur që pikërisht aty ka kaluar periudhën «më të mirë të jetës së tij të varfër», «stinën më të bukur». Imazhi i Palermos *fin de siècle* do të mbetet i pashlyeshëm në zemrën dhe në mendjen e të riut Luigji. Shëtitjet më këmbë a me karrocë përgjatë *Foro Italico* ose nëpër rrugët e gjera të qendrës, rrethuar me ndërtesa të mrekullueshme të stilit *liberty*, mes rrugës *Maqueda* dhe *corso Vittorio Emanuele*, lokalet që frekuentoheshin nga studentët, akulloret dhe kafetë, bibliotekat dhe libraritë, poezitë lirike botuar në revistat më prestigjioze, admirimi për mjeshttrat Giuseppe Pitrè (1841-1916), Salvatore Salomone-Marino (1847-1916), Giuseppe Pipitone-Federico (1860-1940), dëshira për t'i ngjarë Mario Rapisardit (1844-1912) e sidomos adhurimi për Eliodoro Lombardin (1834-1894), diskutimet e zjarrta mbi politikën dhe letërsinë, bëmat dashurore, dyshimet dhe pasiguria për të ardhmen; këto kujtime do të ringjallen shpesh në kohën e pjekurisë dhe as vitet, as buja e suksesit nuk do të mund t'i shlyejnë dot.

Periudha e parë e banimit në Palermo për Pirandello-n zgjati deri në verën e vitit 1885, ndërsa qëndrimi i dytë në Palermo u zgjat për gjithë dimrin e vitit 1886 deri më 14 korrik kur u kthye në Porto Empedocle për pushimet e verës. Prej kësaj në gusht dhe shtator të vitit 1886 i shkroi letrat e para mikut Zef. Këto janë letra të përzemërta, por edhe të trishta, plot «dhimbje të parrëfyeshme», në të cilat shohim një Pirandello «dembel, të mërzitur, indiferent». Atë e mundon ideja se «çastin që mund ta kishte kaluar lumturisht, duhet ta shkojë duke vrarë mendjen me mendime që të mbysin idealin dhe të helmojnë jetën».



Kjo është një periudhë turbullimesh të thella, që në dukje shkojnë përtej shqetësimeve rinore e që më vonë do të rikthehen në formën e kujtimeve autobiografike, por që në të vërtetë s'janë veçse shkëndijat e para të pjekurisë poetike të Pirandello-s. Në fakt në atë turbullim vihen re pasojat e rënda të dashurisë që Luigji ushqente për kushërirën Lina, «katër vjet më e madhe se ai». Së bashku me vëllanë e saj Ettore, «thuaje bashkëmoshatar me Luigjin», dhe me shokë të tjerë ndër të cilët ishte edhe Skiroi, ai shkonte shpesh në shtëpinë e kushërirës. Me Linën, Pirandello ishte dashuruar qysh kur mbërriti në Palermo: «pesëmbëdhjetëvjeçari i pjekur para kohe mbeti i magjepsur nga hiri femëror i zonjushës nëntëmbëdhjetë vjeçare», por asokohe ishte tepër i ri për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm. Fejesa formale me Linën, që u bë në vjeshtën e vitit '87, vetëm në dukje i qetësoi ujërat. Të tjera andralla e presin Pirandello-n. Në Porto Empedocle, siç e thamë më lart, u përpoq të mbante fjalën e dhënë, pra të mësonte pranë të atit zanatin e tregtarit, por nuk ia doli dot të linte mënjatë dashurinë e madhe për letërsinë dhe artin. E kështu zë fill një fazë e re mundimesh për Luigjin, që do ta shpjerë ngadalë dhe pakthyeshem drejt ndarjes me Linën, për t'i dhënë fund një herë e mirë asaj rrokopuje «iluzionesh», «zhgënjimesh» dhe «mashtimesh». Do t'i duhet të presë dy vjet për t'u çliruar nga ajo barrë që ishte bërë e padurueshme. Fillimisht lë Palermon për të shkuar në Romë, duke u larguar kështu fizikisht nga Lina, derisa dy vjet më vonë vë në dijeni të atin për prishjen e fejesës.

Nëse për Pirandello-n mundimet e dashurisë ishin «mizore», nuk ishin më të pakta mundimet që hoqi Zefi. Vasha që u bë shkak i vuajtjeve të tij mbante të njëjtin emër me të fejuarën e mikut: ajo si për ironi të fatit quhej *Lina Pirandello*. Skiro kishte rënë në dashuri me motrën e madhe të Luigjit, Linën, bashkëmoshatare më të, dhe kishte ushqyer shpresën ta bënte për vete, duke i kërkuar ndihmë mikut, të cilit i kishte hapur zemrën «një natë të paharrueshme». Në fakt Luigji nuk mund të bënte asgjë për mikun dhe me një letër të datës 31 korrik 1887 i jep lajmin



«e hidhur» të fejesës së Linës me «një inxhinier të pasur dhe shumë të mençur». Letra e Luigjit dëshmon një lojë të vërtetë mes palëve, një përmbysje të roleve: Luigjit tani i takon të ngushëllojë dhe t'i japë zemër mikut të lënduar, sikurse ai kishte bërë më parë me të. Të bën përshtypje fakti se këshillat e Luigjit janë të njëjta me ato që i kishte dhënë i ati disa ditë më parë këtij të fundit. Po aq përshtypje të bëjnë edhe mendimet mbi Dulcinea-n dhe Aldonza-n, pra mbi faktin se nuk dashurojmë «thuaje kurrë gruan

ashtu siç është në të vërtetë, por gjithmonë siç besojmë se ajo është», po të mbajmë parasysh se pikërisht mbi këtë «mashttrim» u thyen «iluzionet» e tij mbi dashurinë që ushqente për Linën. Luigji natyrisht që nuk donte ta vinte në lojë mikun e dashur, përkundrazi ai u përpoq ta zhdramatizonte ngjarjen përmes sarkazmës dhe t'i jepte tone groteske një marrëdhënie që në fakt nuk ekzistonte, por ishte vetëm fryt i një «dëshire të dëshpëruar» pa shpresë për t'u realizuar.



Ndihma që i dha mikut, këshilla për të mos e marrë seriozisht atë histori dhe për t'i vënë gishtin kokës nuk mjaftoi. Zefi u përgjigj me një letër të hidhur, plot dhimbje e mundim. Luigi mbeti i tronditur nga ajo përgjigje dhe në letërën e datës 12 gusht 1887 shprehu “keqardhjen” për mikun, u orvat t’ia platitë «lodhjen dhe trishtimin» me fjalë ngushëllimi. Nga kjo letër e Luigjit kuptohet se dashuria e Zefit për Linën nuk ishte aq “për të qeshur”, por një ndjenjë e zjarrtë dhe e sinqertë, një dashuri që i riu arbëresh kishte shpresuar vërtet se mund të realizohej. Në fakt Lina në korrik ende nuk ishte fejuar me inxhinierin e minierave Calogero De Castro, por më 16 tetor ’87 do të martohet, duke u transferuar menjëherë në Sardenjë. Pra nuk mbetej asnjë fill shprese për Zefin dhe këtë Luigi ia bëri të qartë mikut. Reagimi i Zefit, i menjëhershëm dhe publik, u shfaq në formën e një *Shënimi hyrës* në vend të parathënies së përmbledhjes poetike me titull *Versi* që doli nga shtypi në fund të vitit 1887. Edhe pse u paraqitën si «këngë të varfra gjimnazisti», ato poezi ishin frymëzuar nga një dashuri rinore, që Skiroi e quajti “trillim poetik”: po të ishte vërtet ashtu, atëherë nuk kuptohet as përse ato poezi do të ngjallnin zemërimin e një anonimi që poeti i ri «nuk njihte e as që donte të njihte», veç në mos bëhej fjala për dikë që ishte dashuruar me të njëjtën vajzë që donte Skiroi, por atëherë nuk do të ishte një trillim poetik, e as përse ia kishte lënë botuesit Amenta barrën të shpjegonte arsyet e rishtypjes së vëllimit.

Një gjë është e sigurt: Skiroi nuk e pranoi lehtë dështimin. Më kot Luigi u rrek ta takonte në Palermo, para se të nisej për në Romë. Më 1 shtator të vitit 1887 i komunikoi se do të mbërrinte në qytet javën e ardhshme, por Zefi jo vetëm që nuk shkoi ta takonte mikun, por i dërgoi një letër që e la pa gojë. Ajo letër, përmbajtjen e së cilës nuk e njohim, e tronditi aq shumë Pirandello-n, sa për të parën herë iu përgjigj pa fjalët e përzemërta me të cilat hapte zakonisht letrat. Është një përgjigje gjithë bezdi, a thua se i dërgohej një të panjohuri a një “armiku”. Edhe ajo “Lamtumirë” e shkarravitur në fund të letrës duket sikur e vulos përfundimisht ndarjen. E me gjithë ashpërsinë e përgjigjes, Pirandello gjen fuqinë ta informojë mikun për planet e së ardhmes së afërt, duke e lënë kështu portën të hapur, a thua se donte t’i thoshte “po deshe, ti e di se ku mund të më gjesh, të pres”.

Në fakt, pas disa javësh, në pusullën e fundit që i dërgon Skiroit në vitin ’87 para se të nisej për në Romë, Luigi e fton të takohen në Palermo. Kësaj here dy miqtë takohen, sigurisht që diskutojnë për zhgënjimin e hidhur të Zefit, ndoshta sqarohen, të ndihmuar edhe nga martesë e Linës, çka me gjasa e shtyu Skiroin ta pranonte faktin që s’mund të zhbëhej më. Me siguri mund të themi se qysh prej asaj dite marrëdhëniet mes tyre nuk do të jenë më si më parë. Në vitet që pasojnë Luigi do t’i dërgojë mikut pak letra, vetëm dy nga të cilat na kanë mbërritur, një në vitin 1888 nga Roma, pak përpara se të nisej për në Gjermani, tjetër nga Boni në vitin 1890. Letrat e tjera që thotë se ka



12

ARBRI I RII

ku brëdhiën Fätiet dua të të siel;
atië çtiin lule truali të çkel,
nata ëë si dita, në i lipsej diel;
amla nkaa fushat t’ëndme buron,
si lumth ndër baar gjela atië çkon.

Mundafçi, Miret të bardhash duar,
duan të na ngchrëjën një shatoree;
atië harrojëm jetën, harruar,
płxiëm gchëszimet tek ajò hjee,
njjii nëngchie vetëm mosse të mbreszur,
kemi të pùthemi, maali të dheszur.

U të rrëfienj atë të çsoj
kuur shihia forën tiij ndë ftiir,
saa parkalësia è saa shërtoja,
me përgchëszime ti më jep glíir,
më limon kript dalëth è dalë,
è thua tue kjeshur : I mieri dialë !

È si virvilet szëen è këndojën
hënszës te pilia, me helm è amlíi,
herët s’kuidësiëm të ç fluturojën,
të lum na vetëm ndë limontii;
te gchlunjët t’at u kriet kumbisur,
ti fldçën t’ime tue dugchulisur.

Në dishirimi i horës thret
saa të shohç vendet të pee të parë,
kuitò, me dritën të ç thikie gchlet,
siit e të vapkjvet, siit sziliarë,
të hapt, të pixur, të ç dhifisiën,
të ç, në jee orexur, szëmbren të ngchrisiën.

Kuitò të plëhmet udha të gjera,
të çtilen sbardhur e lódhien siun,
kuur i përvlón dieli te vera
è të ç te dimbri mbaitenn me shiun,
mosse të luszme gjindie të ç rriëth,
të ç për nj’aaj búkie, shërbën o viðth.

Duam jemi vetëm, rrethur kjetmije,
tek ajò pakje me dashurii;
janë atà kopçtra plot jonisije,
ngchë i vrëerti kuur lip o merii.
Eja, mbre e hjeçme, ka kopilria
ngchë perëndon s’ëndrrat emia.

GIUSEPPE SCHIRÒ

Ivi il suolo s’infiora sotto i tuoi piedi; la notte è come un giorno che non abbia sole; da quelle floride pianure sgorga la voluttà, e, come ruscello via tra le erbe, passa quieta la vita.

Le Mire, dalle bianche mani, ergeranno per noi un padiglione di seta, e là, sotto la freschezza di quell’ombra, racchiusa ogni felicità, obliati, oblieremo il mondo, e, stretti da uno stesso vincolo eterno, ci baceremo.

Io ti narrerò allora le mie sofferenze, nel vederti tanto altera in viso, e i miei delirii e le ansie lunghe d’amore; tu me ne darai gentil ricompensa di carezze, lasciandomi lievemente i capelli, e susurrandomi con un sorriso : povero fanciullo !

Mentre i rosignoli, con mesta dolcezza, canteranno alla luna nel bosco, noi, incuranti delle ore che volano, noi soli, beati in quell’ozio molle, vivremo; poserò la testa sui tuoi ginocchi, tu le mani leggere sul mio viso.

Ma se ti vincerà il mal di paese, il desiderio di rivedere quei luoghi che prima vedesti, rammenta l’occhio vitreo, invidioso dei pezzenti, che, nella trista immobilità dello sguardo tagliente, ti si insinua nell’anima, e te la priva d’ogni letizia.

Ricorda le strade larghe, che si stendono nella bianchezza accidiosa della polvere e stancano gli occhi, quando la state le brucia; ricordale fangose nell’inverno; sempre affollate di gente che corre, e che per un tozzo di pane ruba o lavora...

Là saremo soli, circondati di silenzio; in quella pace tutti i nostri pensieri saranno d’amore; sono quei giardini pieni d’armonia e non li ha turbati mai il dolore o la mestizia.

Vieni, o amor mio, là dove la giovinezza non tramonta come i sogni miei.

traduzione di
LUIGI PIRANDELLO

shkruar kur ishte në Romë, nuk gjenden në arkivin e Skiroit e ndoshta kanë humbur përgjithmonë.

Doemos që heshtja e gjatë e Zefit do të jetë interpretuar nga Luigi si një lloj largimi: edhe ai gjatë muajve që pasojnë nuk do t’i shkruajë më mikut dhe kur vendos t’i dërgojë një letër nga Boni, s’bën gjë tjetër veçse kujton të shkuarën e largët, mallin «për tregtinë e madhe të letrave të atyre ditëve dhe për ëndrrat e bukura të atëhershme», «ëndrra të perënduara». Një dëshirë dhe mall që vetmia gjermane e thellonte, duke i mbushur me trishtim shëtitjet përgjatë lumit Ren. Luigi, i përfshirë nga një valë malli, kopjon dy këngë të poemës *Belfagor* dhe ia dërgon Skiroit bashkë me një letër. Një tjetër këngë të kësaj poeme ia kishte dërguar prindërve më 1 shtator të vitit 1890. Duke komentuar këtë letër, Elio Providenti shkruan: «data e dashur është ajo e fejesës me Linën, gjatë “vjeshtës së freskët” të vitit 1887 për të cilën flasin vargjet [që shoqërojnë letrën]. Më tutje do ta përmendë sërish në letrën e gjatë dërguar të atit në mes të gushtit 1891, ku përmbledh gjithë historinë e asaj dashurie». Prapë hija e Linës pllakos miqësinë që Luigi ushqen për Zefin: malli për “vjeshtën e freskët të vitit ’87”, tashmë të largët, përkund kujtimin e asaj stine, ringjallet dashuria e vjetër dhe e sinqertë për mikun e atyre viteve, por zgjat veçse një çast; pas *muzgut* gjerman bie heshtur mbrëmja mbi Bon. Në Palermo, në *muzgun* italian të vitit 1890, Skiroi do t’ia kthejë nderin mikut duke i kushtuar botimin e parë të idilit *Milo e Haidhee*, hartimin e të cilit Luigi e kishte ndjekur varg pas vargu. Pirandello, nga ana e tij, i rrëmbyer nga dashuria e re gjermane, do të përkthente gjermanisht këngën e parë të poemës së mikut arbëresh, duke e transkriptuar te dorëshkrimi i tij *Gedanken* (1890) i

sapobotuar (shih Giuseppe Faustini, *Un amore primaverile. Inediti di Luigi Pirandello e Jenny*, Mauro Pagliai Editore, Firenze, 2019, f. 181-184). Në marrëdhënien e tyre të heshtur, këto qenë aktet e fundit që vulosën perëndimin e miqësisë së madhe që i lidhi gjatë viteve më të rëndësishme të rinisë së tyre të jashtëzakonshme.

Interes paraqet edhe një çështje që i ka intriguar gjithmonë studiuesit e Pirandellos. E kemi fjalën për njohjen e shqipes nga ana e shkrimtarit të madh italian, i cili pati përkthyer italisht poezinë *Jashta Jetës* të mikut Zef (shih *Arbri i rii*, viti I, nr. III, Palermo, 1887, f. 11-12c). Ka të ngjarë që përkthimin ta ketë bërë vetë Skiroi dhe t’ia ketë ofruar në shenjë homazhi mikut. Në fakt Pirandello kurrë nuk pohoi hapur se e njihte aq mirë shqipen sa t’ia hynte një përkthimi të tillë. Gjithsesi do mbajtur parasysht se Luigi u mor me shqipen, siç del nga shënimet autografe në fletoren e njohur me titullin “Provenzale” që përmban studime të filologjisë romane, shkruar në Bon mes viteve 1889-1891 (shih Luigi Pirandello, *Provenzale. Bonn a/Rh. 1889-91. Manoscritto*, Regione Siciliana Ass. BB.CC.AA. e P.I., Biblioteca-Museo “Luigi Pirandello” di Agrigento, Siracusa, 2002, f. 191). Nuk përjashtohet që Pirandello t’i ketë kërkuar ndihmë mikut Skiroi, i cili asokohe kishte fituar njohuri të thella mbi gjuhën shqipe duke studiuar veprat më të njohura të albanologjisë së kohës, mes të cilave edhe *Albanesische studien* të Johannes Georg von Hahn që u botua në Jenë në vitin 1854 në tri vëllime. Pikërisht vëllimin e dytë të kësaj vepre citon edhe Pirandello. Edhe në këtë aspekt gjenden gjurmët e miqësisë së thellë mes dy të rinjve sicilianë.

STEFAN ÇAPALIKU

“IMAGO & VERBUM”

Prof. Dr. Ferid Hudhri

Midis krijimeve dhe veprimtarive të larmishme (poezi, tregime, romane, drama, regji teatri, regji filmi, ese, ekspozita etj.) me “Imago & Verbum” Stefan Çapaliku këto ditë na ka sjellë një nga botimet më të veçanta në bibliotekën shqiptare. Një marrëdhënie të bukur artistike midis imazhit dhe fjalës.

Ndërsa për shfaqjet teatrore apo filmike Çapaliku (autor dhe regjisor) herë pas here i krijon vetë edhe imazhet e skenografive, kostumeve dhe elementeve të tjera figurative (disa herë edhe posterat apo kopertinat), në këtë libër paraqitet me një raport krejt të ndryshëm në marrëdhënien midis imazhit dhe fjalës (tekstit).

Nga vështrimi i parë i kopertinës “Imago & Verbum” mund të vihem në dilemë nëse kemi të bëjmë me një shkrimtar që shkruan për fotografinë apo me disa fotografi që e frymëzojnë të shkruajë një artist. Çapaliku duket se e ka ndërtuar hierarkinë që në titull, duke vendosur në fillim imazhin dhe më pas fjalën. Libri na kujton gjithashtu se vitet e fundit edhe te ne ka nisur të flitet diçka më shumë se dikur rreth kujtesës kulturore. Madje po bëhen përpjekje për të zgjeruar dhe thelluar të kuptuarit e mënyrave se si funksionon memoria personale në sferën kulturore. Cilat janë tiparet e saj dalluese? Si, ku dhe kur prodhohet ajo? Si e përdorim atë në jetën e përditshme? Si lidhet kujtesa personale ose individuale me format e përbashkëta të kujtesës? Dhe çështje të tjera si këto.

Autori përpaket t'i japë përgjigje këtyre pyetjeve duke përdorur fotografitë personale dhe familjare, që figurojnë të kenë një rëndësi të madhe në zbulimin e kujtesës kulturore. Ai e shqyrton kujtesën kulturore me anë të fotografive, duke ofruar një rrugë veçanërisht produktive për të kuptuar aspektet sociale dhe kulturore të epokës sonë.

Ekziston në fakt një histori e gjatë e marrëdhënieve të fotografisë me antropologjinë. Reflektimi mbi një foto dhe zhbirimi i përmbajtjes së saj është një shtytje drejt kërkimeve antropologjike. Çdo kush e kupton se duke u mbështetur në shembuj konkret mund të hetohet historia e marrëdhënieve të këtyre fotografive me çështje të ndryshme antropologjike. Vihet re lehtësisht edhe ndikimi i fotografisë në një mënyrë të caktuar të rrëfimit të historisë.

Mbështetur edhe në studimin e profesorit Christofer Pinney (*Photography and Anthropology*, London, 2011), Çapaliku na zbulon sesi antropologjia siguron mjetet për të ri interpretuar fuqinë dhe magjinë e të gjitha praktikave fotografike. Aty paraqitet historia e joshjes së antropologjisë nga fotografia, duke artikuluar kështu edhe një teori antropologjike të fotografisë.



Libri i Çapalikut ndahet në pesë ese (për kosekuencë me titullin, edhe ato paraqiten me emra latinë), si: *Imago historiae* (Imazhi i historisë), *Imago somnium* (Imazhi i ëndrrës), *Imago mundo* (Imazhi i botës), *Imago dei* (Imazhi i zotave), *Imago temporis* (Imazhi i kohës). Nëpër faqet e librit ai ndalet më gjatë me disa foto të familjes Marubi, të Dedë Jakovës, të fotografit francez Michel Setboun dhe të tija vetë.

Ngjarjet e librit lëvizin në një periudhë prej më pak se njëqind vjetësh duke na sjellë ndër mend pika kyçe të raporteve të njeriut me veten, lirinë, politikën dhe ëndrrat.

Kjo qasje individuale, stili i lirë dhe i hapur, thirrja për bashkëpunim me lexuesin e cilësi të tjera si këto e bëjnë librin një doracak të çmuar estetik veçanërisht për studentët e artit dhe të antropologjisë kulturore.

STEFAN ÇAPALIKU

imago & verbum



"BUZUKU" DHE

ABDULLAH ZENELI

DEKOROHEN ME

TITULLIN "NAIM

FRASHËRI"

Me propozim të Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, presidenti i Republikës Z. Ilir Meta e dekoroi Shtëpinë Botuese ‘Buzuku’ me Titullin “Naim Frashëri”.

Ky vlerësim i lartë vjen në 30-vjetorin e saj.

Tre dekada më parë, në kushtet tejet të rënda të aparteidit serb, lindi në Prishtinë, Shtëpia Botuese ‘Buzuku’, e para e pavarur në krejt hapësirën ku flitet shqip.

Kjo nismë sa e dobishme, aq edhe e guximshme për kohën, lidhet me emrin e Abdullah Zenelit, i cili vinte nga shkolla e të mirënjohurës “Rilindja”.

“Buzuku” po hynte në jetën shpirtërore të shqiptarëve për të bërë histori me botimin e shumë veprave artistike e historike të elitës intelektuale, duke paraqitur identitetin, kulturën, shpirtin krijues të kombit dhe vlerave të qytetërimit shqiptar.

Është fakt se ne kemi sot në bibliotekat tona kontributin e çmuar të “Buzukut” për promovimin e shumë thesareve të letërsisë tonë të traditës dhe asaj bashkëkohore.

Një faqe veçanërisht e merituar në veprimtarinë botuese të ‘Buzukut’ shënohet me gjurmimin dhe nxjerrjen në dritë të shkrimtarëve shqiptarë, si në Prishtinë edhe në Tiranë, të mohuar me dekada nga censura politike për shkak të ideve të tyre.

Kjo punë e madhe dhe në kushte shumë të vështira në shërbim të kulturës shqiptare si një e tërë, përtej ndasisë së kufijve shtetërorë, e vendos z.Abdullah Zenelin dhe ekipin e ‘Buzukut’ në trashëgiminë frymëzuese të Rilindjes sonë Kombëtare.



PANAIRI I LIBRIT

"TIRANA 2020" DO TË

ZHVILLOHET ONLINE

Sot u zhvillua mbledhja e zgjeruar e kryesisë së Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, me temë: Organizimi online i Panairit të 23 të Librit të Tiranës, në kushtet e pandemisë Covid-19.

Të bindur që Panairi i Librit është një ngjarje madhore, e cila nuk duhet t'i mungojë qytetit të Tiranës, por edhe lexuesve nga gjithë vendi, të gjithë të pranishmit ishin të një mendjeje për organizimin, në ditët e caktuara që më parë, të një Panairi Libri, kësaj here në një edicion special, kryesisht online, për shkak të pandemisë.

Ky Panair do të karakterizohet nga një bashkëpunim i gjerë i botuesve shqiptarë.

Gjatë ditëve të tij, botues, shkrimtarë, poetë, përkthyes, lexues dhe njerëz të kulturës do të takohen për diskutime librash, prezantime titujsh të rinj, por edhe tryeza debatesh, në live stream, ose në mjedise fizike, duke respektuar të gjitha kushtet e sigurisë.

Që sot ka filluar puna për organizimin e Panairit të Librit Online.

Qendra e këtyre veprimtarive do të jetë qyteti i Tiranës që këtë vit ka 100-vjetorin e tij.

Shoqata e Botuesve Shqiptarë

(In memoriam në 85-vjetorin e lindjes)

VIKAMAT E TINGUJVE TË FEIM IBRAHIMIT

Nga Enver Kushi

Dhe do të vijë heshtja
Se çdo vikamë fillon
Dhe mbaron me heshtje...
Migjeni

Shënimet për librin e Vera Ibrahimit “Vikama e tingullit”, i gjeta rastësisht, teksa shfletoja librin e saj... Mbj mend, që në shtator ose në tetor të vitit 1997, Vera do të më jepte për të lexuar, faqen e parë të librit. Ishin orët e paradites dhe unë në këmbë, në zyrën e saj të vogël në Ministrinë e Kulturës, e lexova dhe rilexova disa herë atë faqe. Më bëri përshtypje kultura e të shkruarit dhe emocioni që përcillej në ato pak rreshta. Dukej një dorë e stërvitur. Ja thashë menjëherë këtë. Ajo, si gjithmonë modeste dhe fisnike, më falenderoi. Pastaj shkova në zyrën time dhe nga dritarja, hodha vështrimin jashtë. Dukej godina e Qeverisë, bulevardi i pluhurosur dhe ushtarë të armatosur në trotuarin përballë. Ishte vjeshtë e trishtë, me pluhur, krisma, netë dhe ditë ankthi, lajme absurde nga një Shqipëri absurde, katandisur kështu fatkeqësisht nga një politike tej absurdes. Të gjithë, kush më shumë e kush më pak, ishin me plagë. Por Vera ishte shumëfish e plagosur. Fillimgushtin e 1997-ës, në Torino, kishte ndërruar jetë, bashkëshorti i saj, një nga kompozitorët më të shquar e më fisniku i racës së artistëve shqiptarë, Feim Ibrahimit... Ishte një humbje tronditëse për Shqipërinë e më gjerë... Vera Ibrahimit me dinjitet përballoi gjëmën dhe po me aq dinjitet, diti që plagën e madhe ta mbante brenda vetes. Ishte një stoicizëm i admirueshëm ballkanik, që padyshim kishte në të edhe nga stoicizmi dhe fisnikëria e grave shkodrane. Në sytë e mi (dhe jo vetëm), kjo e fisnikëroi më shumë atë...

Dhe kur lexova atë ditë fillimin e librit për Feimin, m'u duk sikur preka plagën e saj të madhe e të pashërueshme dhe ndjeva edhe mall të papërballueshëm e ca vikama tingujsh, po aq të papërballueshëm e hyjnorë. Vera Ibrahimit, si në rrëfimet mitologjike të të parëve të mi thesprotë, që pasmesnetëve të pagjuma, flasin me të vdekurit brigjeve të lumit tim mitik Aheron, në qendër të Tiranës, thërriste shpirtin e Feim Ibrahimit. Dhe ai vinte menjëherë, ashtu siç ka qenë: me të qeshurën karakteristike dhe i zbehtë.

...Sepse ky libër nuk mund të shkruhej ndryshe, veçse në këtë atmosferë mistike, ku i gjalli me të vdekurin natyrshëm flasin me njëri-tjetrin.

Shënimët për librin “Vikama e tingullit”, janë mbajtur gjatë ditëve kur e lexova atë. Ato janë impresione të çastit dhe botohen ashtu siç kam shkruar në ato ditë të nxehta korriku.

Pa datë. Korrik

Kam ditë që lexoj librin e Vera Ibrahimit “Vikama e tingullit”. Është nga librat e rrallë, botuar vitet e fundit, që e lexoj me emocion të veçantë dhe çdo faqe e tij më drithëron. Mos ndoshta kjo ka të bëjë me faktin se Verën e njoh prej vitesh dhe tani jam në një zyrë me të? Apo që edhe Feimin e kam njohur dhe me aq pak njohje, kam parë tek ai vazhdimisht nga të rrallët fisnikë të racës së artistëve? Nuk e besoj... Libri i Verës është det ndjenjash dhe emocionesh. Vërtetë kam

kohë pa lexuar një libër kaq drithërues. Nuk është kuartet harqesh. As orkestër e vogël... Libri i Verës më duket se është një orkestër madhështore, me qindra orkestrantë dhe me një dirigjent të çuditshëm, që komandon ose dirigjon mrekullisht fjalën, këtë magji të shpirtit njerëzor. Vera, këtë magji që quhet fjalë, herë-herë i jep drithërimën dhe ndjeshmërinë e notave muzikore. Këtu fjala është edhe tingull drithërues njerëzor, edhe dritë, edhe muzg, edhe natë, edhe... Edhe amshim.

24 korrik. Bibliotekë. Pasdite.

Libri i Vera Ibrahimit, i kalon caqet e një libri thjesht kujtimesh. Ai i ka të gjitha: edhe kronikën e jetës, edhe kujtimet, edhe të përditshmen, botën artistike shqiptare me arritjet e padiskutueshme, por edhe me provincializmin, mediokritetin, ligësitë vulgaritetin e kohës që lamë pas, edhe anatominë e procesit krijues ose laboratorin e kompozitorit të madh Feim Ibrahimit... Ajo njeh mirë edhe muzikën, duke zbërthyer estetikisht, me profesionalizëm, veprat muzikore të bashkëshortit të saj.

E njejta ditë. Afër mesnatës. Shtëpi.

Kjo grua fisnike, që unë kam patur fatin të punoj vite më parë në Ministrinë e Kulturës dhe më pas në një zyrë në Muzeun Historik Kombëtar, në këtë libër shfaq talentin e saj si shkrimtare e vërtetë. Ajo mund të mos shkruajë më... Ndoshta edhe mund të shkruajë... Kjo s'ka rëndësi. Ky libër, me një tekst të ngeshur emocional, ku shpaloset një epokë dhe një kompozitor i shquar, duhet të futet në programet e shkollave të muzikës në Shqipëri dhe Kosovë. Në të do të prekni dhe njiheni me punën e palodhur të kompozitorit. Në të gjitha vitet, që kam kaluar me Feimin, shkruan Vera, kohë-jeta e Tij ka një skemë të pazakonshme me jetën e njerëzve të profesioneve të tjera. Ushtrime në piano, pastaj kompozim, lexime të panumërta partiturash, poezishë, biografishë të njerëzve të shquar, shkrime teorike rreth muzikës nga teoricienë arti, librash filozofike. Letërkëmbime, përkthime. Vazhdimisht përsosje në gjuhën frënge e ruse, madje edhe mësimet në anglisht. Pothuajse asnjë orë para televizorit, sepse dëgjon vetëm lajmet në stacionet më kryesore, ose kur transmetohet muzikë simfonike, instrumentale, balete, opera... Punë, punë shumë e madhe do të jetë deri në fund të jetës motoja udhërrëfyese e Feimit.

Muze. Zyrë. Ora 10 e datës 25 korrik. Vapë e madhe.

Vetëm ajo mund të depërtojë aq mjeshtërisht dhe thellësisht, në jetën e njeriut me emrin Feim Ibrahimit dhe kompozitorit të shquar me emrin e pavdekshëm Feim Ibrahimit... Kur lexon Verën thua: “Jo fjala, por tingulli tronditës, që më shumë se fjala depërton në misteret e jetës dhe shpirtin e njeriut, është i pari...”. Ndoshta njeriu i parë, para se të artikulonte fjalën e plotë, me siguri, ka “folur” me tingujt muzikorë... Libri i Verës, më rikthen në vitet

e rinisë time të hershme, atëherë kur dëgjoja këngën e filmit “Ngadhënjim mbi vdekjen” apo qershorin e vitit 1978, kur i mbërthyer pas ekranit të televizorit, dëgjoja zërin tronditës të Rikard Larjes dhe muzikën epike, po aq tronditëse të Feim Ibrahimit. Mbj mend se isha mësues i letërsisë në shkollën e mesme të Rrogozhinës dhe 100-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, nëpërmjet edhe poemës vokalo-simfonike “Tan Shqipnia asht betue” të Feim Ibrahimit, erdhi e prekshme, dramatike, e gjallë si asnjëherë tjetër... Ishte një muzikë himn. Ndoshta do të mjaftonte vetëm ajo, për të ngritur mijëra shqiptarë të Kosovës për liri e pavarësi. Faleminderit Vera, që me librin tënd, më riktheve emocionet e rinisë sime.

E njejta ditë. Ora 14⁰⁰

I qetë në dukje, me një mirësi e buzëqeshje të përhershme në portretin e tij, Feim Ibrahimit në brendësi dallgëzonte. Dhe s'mund të ishte ndryshe njeriu Feim Ibrahimit nga kompozitori Feim Ibrahimit. Vera, në librin e saj, ka dhënë botën e dallgëzuar të njeriut dhe kompozitorit. Dallgëzimet në muzikën e tij janë të brendshme, në thellësi. Dhe dallgëzimet në thellësi janë më të fuqishme, më tronditëse se ato në sipërfaqe. Kjo është veçori e artit të vërtetë të të gjitha kohërave. Feim Ibrahimit jetoi në një kohë të trazuar dhe krijoi një muzikë të trazuar, thënë ndryshe, në të ndjehen dallgët e brendshme të saj. Vera Ibrahimit, në këtë libër homazh e të rrallë, e jep bukur këtë anë të jetës dhe veprës së bashkëshortit të saj. Libri i Verës, për ata që dinë të lexojnë, dallgëzon nga brenda. Nuk është i rastit titulli i librit. Sipas “Fjalorit të Gjuhës Shqipe”, fjala VIKAMË ka këtë kuptim: britmë, thirrje, vigmë. Dhe fjala VIGMË ka kuptimin: klithma që njerr njeriu në rast fatkeqësie, nga dhimbja që ndjen etj., britmë e madhe, sokëllimë. I tillë është ky libër, fund e krye një dhimbje dhe britmë e madhe për ndarjen para kohe nga jeta

të kompozitorit Feim Ibrahimit, krijimtaria e të cilit është vikamë më vehte e mijra tingujve...


Kompozitori Aleksandër Peçi në shkrimin “Biografia e Vikamës së një Epoke”, botuar në gazetën “Drita”, më 10 gusht të vitit 1979(cituar i plotë nga Vera Ibrahimit, në librin e saj), i bën një analizë të thellë, duke shkruar më tej, “Trios Vikamë për violinë, për violë, violonçelë”, premiera e së cilës u dha më 21 maj 1996, në Akademinë e Arteve: “E tillë është vikama me të cilën kompozitori Feim Ibrahimit përshëndeti botën muzikore të viteve '60-'70. Ishte klithmë e një lindje të re si kompozitor e që do të zgjonte mëngjese të reja për botën muzikore shqiptare...ajo do të piskante fuqishëm për një identitet kombëtar modern e drejt rireformimeve bashkëkohore...si fenomen sonor, por edhe si fenomen estetik, sinonimati vikamë-piskamë-klithmë e Ibrahimit, formuloi gjatë gjithë jetës tek ai profilet e një krijuesi antidogmë e antikonservator...vepra e Feimit është një refleksion i vikamës së madhe të Atdheut, që thyen e përtyp klithma tragjedish, që lind e varros bijtë e vet, që e bëjnë t'i fryjnë erëra lotëndjellëse e që ëndërron t'i vesëzojë mëngjeset e shpresave”.

Më emocionojnë edhe marrëdhëniet e Feimit dhe Verës me vajzën e tyre të vetme, Etrin, tashmë pianiste e talentuar. Etri, shkruan Vera, me tingujt e saj na krijoi një botë të dytë, tepër të mundimshme, por që asaj dhe ne, shumë herë na blatoi kënaqësi të jashtëzakonshme, mosqënie në Tokë dhe fluturime qiellore... Ai donte të nderohej edhe me kryeveprën e Tij, Etrin, dhe prandaj bëhet kujdestar, pedagog, kritik i rreptë, bashkëpunëtor, konsulent...

Intermexo: Kronika e jetës

Feim Ibrahimit lindi në 20 tetor 1935 në Gjirokastrë.

Në vitin 1962 në Konservatorin e sapokrijuar të Tiranës, nisi studimet nën





drejtimin e Tish Daisë, që e përfundoi në 1966.

Në vitet 1966–73 dha mësim në degën e kompozicionit, kontrapunkt dhe harmoni, në Konservator, e më pas mbajti postin e Nëndrejtorit të Institutit të Lartë të Arteve. Në vitet 1977–1991 emërohet Sekretar për Muzikën në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë dhe më vonë edhe Drejtor i Përgjithshëm i Teatrit të Operas dhe Baletit, (1991–92).

Nga viti 1992 -1997 ishte profesor i teorisë dhe kompozicionit në Akademinë e Arteve.

Gjatë të gjithë karrierës së tij, ai u përpoq të çonte muzikën shqiptare në skenën muzikore europiane.

Nga viti 1978-1991, punoi pa reshtur për pranimin e muzikës shqiptare në UNESCO dhe në 1991 ai u bë presidenti i parë i Këshillit Kombëtar të Muzikës, duke arritur më në fund, ta bënte atë, anëtar të Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës në UNESCO.

Për të rritur zhvillimin e kompozicionit shqiptar, në vitin 1992, Ibrahimit themeloi festivalin “Mbrëmje të Muzikës së Re Shqiptare”.

Në 1994 themeloi shoqatën artistike “Pentaton” (sot Fondacioni Kulturor “Feim Ibrahimit”), me synim organizimin e veprimtarive kulturore, si edhe ngritjen e një konservatori privat për fëmijë të talentuar. Disa nga veprat e tij janë botuar në Angli prej Emerson Edition.

Për meritat artistike, në 1989, shteti shqiptar i akordoi titullin “Artist i Popullit”, titulli më i lartë artistik i Shqipërisë.

Në vitin 2000, Bashkia e Tiranës i akordoi titullin “Mirënjohje e Tiranës”, për kontributin e tij në kulturën shqiptare dhe veçanërisht për kulturën e kryeqytetit.

Në 2001, Bashkia e Durrësit (qyteti ku kishte kaluar fëmijërinë dhe rininë e tij), i dha titullin Qytetar Nderi.

Në 2008, Bashkia e Gjirokastrës, qytetit të tij të lindjes, i akordoi titullin “Qytetar Nderi” dhe i vuri emrin e tij shkollës së mesme rajonale të muzikës.

Emrin e Feim Ibrahimit e mbajnë rrugët në qytetet Gjirokastrë, Durrës dhe Prishtinë.

Ibrahimit ka fituar shumë nga çmimet kombëtare dhe ato të “Koncerteve të Majit” (aktiviteti kryesor muzikor i përvitshëm që prej 1967-s).

Ka fituar dy herë “Çmimin e Republikës” – çmimi më i rëndësishëm për veprimtarinë krijuese.

Në 1990, në Aalto Theaterfoyer, në Essen (Gjermani), u organizua një koncert-portret, që përmbante edhe një leksion mbi muzikën e tij.

Në 1994, me ftesën nga Brahms-Gesellschaft, Ibrahimit ishte composer-in-residence në Brahmshaus të Baden-Baden-it (Gjermani) dhe menjëherë pas kësaj studioi muzikë elektro-akustike në Mozarteum në Salzburg (Austri).

Në 1995 vepra e tij “De Profundis”, kompozuar gjatë qëndrimit të tij në Salzburg, u përzgjedh për festivalin e muzikës elektro-akustike në Bourges, Francë.

Muzika e Ibrahimit shtrihet thajse në të gjitha zhanret: miniatura instrumentale, muzikë filmash, muzikë dhome, koncerte për instrumente solo dhe orkestër, simfoni, balet dhe vepra vokale. “Dialogo” për violonçel dhe piano, si dhe romanca “*E la tua veste è bianca*” (sipas një poeme të S. Quasimodo-s) për soprano, violonçel dhe piano, (të dyja të kompozuar në qershor të 1997-s), janë veprat e fundit të kompozitorit, i cili u largua nga jeta në 2 gusht 1997, në Torino, Itali.

Pa datë

Ky libër është shkruar gjatë netëve të tëra dhe natyrisht, si çdo libër apo krijim artistik, në vetmi. Vera, e ngarkuar emocionalisht me qindra dhe mijëra orë dhe ditë të së kaluarës, si një magjistare, i ka thirrur ato, ditët dhe netët e shkuara të Feimit e të sajat. Dhe si në artin e madh surrealit, befas, ka rizgjuar kohën e shkuar. Duket sikur ato rrëfejnë, herë-herë me radhë në mënyrë kronologjike, por në të shumtën e rasteve, ato dalin nga radha. Vitet 1969-1971. Pastaj 1983. Prap viti 1971. 1978. Është një vit ulëritës ky. E më pas, i shpërfytyruar vjen gushti i 1997-ës: i verdhë, meit, hënor, me pak fjalë, me sy të tharë nga dhimbja, i ngrirë me një kohë pa kohë...

Vera lë menjandë fletën e bardhë dhe ndez cigaren. E thith ngadalë. I hedh një vështrim të shpejtë derës, pastaj telefonit, prap derës dhe orës së madhe në mur... Ka kaluar mesnata... Është koha kur vjen Ai, me të njejtën buzëqeshje dhe mirësi... Ajo ka kohë që e pret. Ka nevojë për rrëfimin e tij. Dhe Vera nis e shkruan: “Mirëpo në mes të ëndrrave, në orën 2-3 pasmesnate, dikush e zgjon. Është një zë i brendshëm, që e urdhëron të ngrihet. Pa ndezur abazhurin, duke mos dashur të më prishë gjumin, hedh diçka krahëve dhe shkon në studio. I afrohem vjedhurazi derës. Asnjë zhurmë. E hap ngadalë dhe pamja e tij me mbetet e fiksuar përjetësisht: i ulur në piano, me laps në dorë, e i përkulur mbi partet e lëna ashtu, të hapura...

... Kur ka ndodhur kjo? Në çnatë? Në çmuaj? Në çvit? Nuk e di. Se përcaktoj dot, sepse ishte e shpeshhershme, madje më duket se edhe tani. Ai është përsëri aty, në studio, megjithëse piano hesht...”

I tillë është ky libër: shkruar me shpirt ose rrëfim për një shpirt, që ka fituar përjetësinë.

Këtu është pak a shumë historia e një kompozitori, që edhe pranë vdekjes hodhi në partiturë nota muzikore. Luftoi të shpëtonte, shkruan Vera, por nuk arriti dot. Atëhere hapi krahët dhe u zhduk drejt të panjohurës. Është një histori, që flet për jetën dhe bukurinë e saj, për shortet dhe qëndrueshmërinë, për mundësitë e jetës së vërtetë dhe vdekjen...

Shënimi i fundit: Brenda dhe jashtë tekstit

Tirana në të gjitha stinët, ka ditë që qiejt e ngarkuar me retë gri, derdhin shira të rrëmbyer zemrak, inatçorë. Ndoshta të tillë kanë qënë këto shira, që nga fillesat e këtij qyteti, por nuk e di pse, më duket se kohërat e fundit ato janë si shpërthime dufesh për të rizgjuar shpirtin dhe kujtesën e këtij qyteti. Këto mendoja fundshkurtin e këtij viti, pasi kishim përcjellë për në banesën e fundit Fuat Çanon, një gjirokastrit të mënçur dhe



të heshtur. Ai u varros, sipas amanetit që i kishte lënë të shoqes, Natashës, në një varr me nënën, që vinte nga derë e Shaplllove. Varri ishte në fillim të varrezave të Sharrës, ose mos gaboj, në parcelën e parë, ku ndryshe nga të gjallët, që jetojnë në lagje, ajo e të vdekurve nuk quhet lagje, por parcelë.

Që nga mëngjesi i asaj dite, në Tiranë derdhte dufin e tij shiu i vrullshëm. Dhe ndërsa kthehesha përmes varreve, për të dalë në rrugën kryesore të qytetit të të vdekurve, befas syri më zuri portretin e qeshur të Feim Ibrahimit. U afrova pranë tij dhe preka me dorë, në fillim fotografinë e vendosur në pjesën e sipërme të mermerit dhe më pas notat e pentagramit, që ishin hedhur në një pjesë tjetër mermeri, që ngrihej lart. Ky nuk është varr i zakonshëm, thashë me vehte, është më shumë se vepër arti. Skulptori, Mumtaz Dhrami edhe këtu, për mikun e tij Feim Ibrahimit, ka ngritur një monument, që flet shumë. Sipas skulptorit, pjesa e ngritur e mermerit, është një krah ëngjëlli dhe notat muzikore të pentagramit të ngrira në këtë krah janë të romancës “Lamtumirë miku im, lamtumirë”. Feim Ibrahimit këto nota muzikore i hodhi në letër, pak kohë para se të ndrronte jetë, frymëzuar nga vargjet e mrekullueshme të poetit të madh rus, Esenin.


Kujt u flasin këto nota muzikore të gdhendura në këtë krah ëngjëlli, që vazhdon të rrihet nga shiu i vrullshëm: të gjallëve, apo të vdekurve? E ndërsa u largova, nuk dëgjoja asgjë: as shiun, as zërat e njerëzve që kalonin, as lutjet e fëmijëve romë që zgjatnin duart, as... Më pas, teksa autobusi u nis, hapa perden, duke parë varret e parcelës nr.1. Dhe përmes shiut që binte, nga varri monument i Feim Ibrahimit, krahas tingujve të romancës “Lamtumirë miku im”, më ndiqnin nga pas edhe mijra tinguj, ose vikama tingujsh, që kompozitori i madh kishte lënë pas. I telefonova Verës dhe i tregova për shiun e rrëmbyer që binte në varrezat e Sharrës, për portretin e qeshur të Feimit dhe pentagramin si krah ëngjëlli të varrit të tij... Atëhere mendova për vdekëtarët e medhenj të këtij qyteti, që nuk janë më, shkrimtarë, piktorë, skulptorë, kineastë, artistë të tjerë, e midis tyre edhe Feim Ibrahimit, që edhe i vdekur vazhdon të na japë gëzime, sa herë dëgjojmë këngët e veprat muzikore të tij...dhe m'u kujtuan vargjet e një poezie të Xhevahir Spahiut kushtuar kompozitorit të madh, që nuk është më:

Ti buzëqesh pa thënë asnjë fjalë,
Tingujt janë kthyer në fllad a rrebesh.

Tiranë, vjeshtë e dytë 2020

RISITË NARRATIVE E STRUKTURORE TË RIDVAN DIBRËS

Nga Ismet Aliu



Mund të pohojmë se romani “Legjenda e vetmisë” është vepër romanore e shkruar krejtësisht ndryshe, që tregon përkushtimin dhe guximin krijues të autorit. Nëse këtë autori e ka pasur qëllim, ia ka arritur.

Madje, edhe në qoftë së Ridvan Dibra ka bashkuar ndonjë elemente të tekstit postromantik, modernist dhe ndonjë element shumë të rrallë postmodern, (lloj teksti që ka krijuar njëfarë klisheu në postmodernizëm), ai këtë nuk e ka bërë që të krijojë një eklektizëm drejtimesh a rrymash letrare, por përkundrazi, këtë e ka bërë me qëllim që të largohet sa më shumë nga tri drejtimet, dhe kështu të krijojë diçka të re në letërsinë shqipe. Tekefundit nga guximi i autorëve të ndryshëm, në kohë dhe hapësira të ndryshme, kanë lindur zhanret dhe drejtimet, rrymat letrare, por, natyrisht, edhe kryeveprat.

Dhe tani, gëzon fakti se romani që prezenton shkëlqyeshëm letërsinë shqipe, përkatësisht romanin shqiptar është përkthyer në gjuhën frenge.

Shkrimtari Ridvan Dibra, i njohur për lexuesin shqiptar me veprat: “Thjeshtë”, “Eklipsi shpirtit”, “Prostituta e virgjër”, “Nudo”, “Stina e ujkut”, “Franc Kafka i shkruan të birit”, “Në kërkim të fëmijërisë...”, e sidomos me “Triumfi i Gjergj Elez Alisë” dhe “Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë”, me të cilat, (disa nga to) veçmas me “Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë” solli jo sall triumfin personal, por triumfin e postmodernes në hapësirat e letërsisë shqiptare, duke e pasuruar edhe më tej; dhe, tani së fundi, paraqitet me romanin “Legjenda e vetmisë”, vepër për shumëçka interesante, materiali, brumi i së cilës shtrohet dhe strukturohet krejtësisht ndryshe. Dhe ky ndryshim, që vjen përmes prozës romanore moderniste me një tis të hollë ngjyrimesh postromantiste, është diçka e re jo sall në opusin autorial, por edhe më gjerë. Pse është risi ky roman? Çfarë e bën të re këtë vepër?

Së pari, te romani “Legjenda e vetmisë” kemi një strukturë tekstore të re, një sintaksë të re të fjalisë dhe një strukturim krejtësisht të ri të përmbajtjes që autori e përcjell deri te rcepienti me lehtësi e thjeshtësi, prej të cilës buron magjia e bukurisë artistike narrative. Në tridhjetë kapitujt e romanit kemi një unitet përmbajtësor dhe harmoni të përkryer tekstore, përmes të cilave ndërtohet diskursi letrar tekstor e strukturor si dhe poetika gjuhësore që shenjëzon dhe krijon hapësirën unike, të pandashme, të tërësisë narrative. Një tekst me petk të ri dhe me përmbajtje interesante, i zhveshur nga çdo lloj përshkrimi që nuk lejon shpërqendrimin e vëmendjen nga esenca. Pra, Dibra na sjell esencën, dhe lexuesin e fut në esencë përmes sekuencave të esencës, e jo përmes lagjeve periferike narrative. Tërë këtë e bën me fjali të shkurtër, dinamike e me saktësi të mpreht, me parimin e ekonomizimit që ta kujton poezinë. Çdo kapitull nis me tri fjali të shkurtra që janë nyje tekstore të kapitullit dhe përfundon poashtu me tri fjali që do të mund të merrej si epilog i kapitullit. Edhe ata të fillimit të kapitullit edhe këto të përfundimit kanë rolin e fjalëve çelës si tek poezia.

MODERNIZMI/POSTMODERNIZMI APO DIÇKA JASHTË TË DYJAVE

Si duket, Dibra duke qenë përherë gjurmues i avangardës risisë, e veçmas te “Legjenda e vetmisë”

është stërngopur me prozën postmoderniste (përfaqësuesit më eminent të letërsisë shqipe: R. Qosja, (modernist, postmodernist), pastaj B. Blushi, B. shehu, A. Apolloni, B. Hoxha, Z. Rrahmani, K. Rrahmani etj.) por edhe me prozën moderniste (përfaqësuesit më eminent (I. Kadare, A. Pashku, F. Arapi, D. Agolli, T. Dervishi, B. Musliu, M. Ramadani, Z. Rrahmani, M. Kraja, A. Tufa, G. Krasniqi, A. Leka, G. Aliu etj.,) prandaj dhe bën përpjekje të krijojë diçka të re, krejtësisht të re, që do të ishte jashtë shabloneve e stereotipeve, të cilat, edhe pa dashje krijohen qoftë si frymë, qoftë si model, madje edhe te pjesa më e shëndetshme e letërsisë. Prandaj hasim sekuenca që tentojnë të sjellin risi brenda opusit autorial, ose tendencë për risi brenda letërsisë, gjë të cilën e kemi hasur si sekuencë edhe më herët të Dibra, por te proza romanore, “Legjenda e Vetmisë” tani më është qëllim parësor që të krijojë diçka te re.

Autori krijon një tekst autorial homogjen-artistik dhe një poetikë krejtësisht origjinale që ngërthehet brenda stilit personal, ku të folurit poetik ndërtohet me figura të lehtëzbërthyeshme por megjithatë të fuqishme e domethënëse dhe ku fjalia e shkurtër, e saktë e dinamike, ndonjëherë me varg të thyer qëllimshëm, ka një fuqi dhe bukuri sintaksore dhe mjetet artistike së bashku me mesazhin e pasazhin e sekuencat e ndryshme ndërveprojnë duke krijuar marrëdhënie në ndërtimin e tërësisë tekstore, të ngjarjes.

Romanin “Legjenda e vetmisë” nuk mund ta definojmë thjeshtë si krijim sall modern me elemente të atyktueshme postmoderne, ngase shohim se autori nuk ka pasur për qëllim drejtimin, rrymën letrare, por qëllimi i tij final ka qenë të krijojë diçka jashtë dy rrymave, e kujtoj se ka arritur që të krijojë një tekst romanor që mund të quhet *thjeshtësi e bukur*

dhe që frymon jashtë dy shabloneve të mëdha, dhe së këndejmi ka arritur t’i bashkojë së paku për afro një lexuesit: atë model dhe lexuesin e painformuar mirë mbi letërsinë. T’i afrojë në atë mënyrë që të mos ketë polarizime e kundërshtime të mëdha për tekstin.

Mahnitëse është, madje për çfarëdoqoftë kategorie lexuesish fakti se si Ridvan Dibra përmes një thjeshtësie të paparë arrin deri te zemra e së bukurës trishtuese.


Diskursi mitik, realja dhe arealja, brenda prosedeut romanor na jepen përmes një gjuhe poetike që vë në spikamë relacione me gjuhën e përditshmërisë. Ai shkrin prozën narrative, prozën poetike, si këtu: (*Hëna është e plotë dhe gjaku mbi gjoksin e atit duket si argjend i shkrirë. F.21*) poezinë konkretiste dhe gjuhën e përditshmërisë, dhe kështu krijon një mesazh që në asnjë moment, në asnjë pjesë të tekstit të mos krijojë refuzim tek rcepienti.

Fjalia në tekst është e shkurtër e thukët e saktë, ndonjëherë e rrudhur qëllimisht, figuracionale ose e pathënë, në kuptimin e papërfunduar, që pasqyrohet përmes pikave të heshtjes, e cila të gjithë hapësirën tekstore e shenjon si hapësirë të parëndomtë të ngulfatjes së një vetmie tragjike e të rëndë, ku nuk flitet shumë, pos asaj që është e domosdoshme. Në këtë tekst edhe ëndrrat, edhe kujtimet, edhe shpresat poashtu, si shënjesht referencial të shqiptimit dhembjes, na jepen përmes një gjuhe të saktë, të prerë nga rrethana frike e dënësesh. Teksa e lexojmë romanin “Legjenda e vetmisë”, po e përsëris edhe njëherë, se shohim që autori ka pasur guxim të zbrësë në thellësitë marramendëse të thjeshtësisë së bukur, dhe prej andej e ka nxjerrë të bukurën e madhërishtme, artistiken, si kategori estetike, të pëlqyeshme dhe të pranueshme për të gjithë, pra të bukurën që mëton të universalizohet.

Ridvan
Dibra

Le Petit Bala La Légende de la solitude

Texte traduit de l'albanais
par Evelyn Noygues



Le
Ver
à Soie

RIDVAN DIBRA

legjenda e vetmisë



Onufri

Ridvan Dibra subjektin për romanin “Legjenda e vetmisë” e merr nga eposi i këngëve kreshnike, gjë të cilën na e lajmëron në hyrje të romanit, duke vendosur distihun: “*Nana djalën ka qorrue, / me gjaks t’ burrit m’u martue*”. Vargje që janë shenjuese të materies dhe prej të cilave të ngjethet misht. Krejt teksti romanor të “Legjenda e vetmisë” ka disa pika kyçe, apo nyje narrative, të cilat nyjëtohen në një pikë të vetme dhe ndërtojnë esencën romanore, përmes të cilës ne kuptojmë se deri ku mund të arrijë errësira njerëzore. Rrathët referencial që e përshkojnë dhe e ushqejnë esencën do të ishin: a) Vrasja me paramendim, b) fshehja e krimit, c) përsëritja e krimit, ç) dy skajet e vetmisë së Balës, vetmisë që merr përmasa mitike e tragjike... Dhe, në gjithë këtë vetmi, në qendrën e saj të ftohtë oqeanike ndodhet Bala tragjik.

KRIJIMI I PERSONAZHIT TË QËNDRUESHËM

Dibra krijon personazhin kompleks e të qëndrueshëm, tiparet e të cilit mund t’i gjejmë te tragjeditë antike ose tek klasiku e babai i tragjedisë: Shekspiri. Në tekstin romanor, autori gjen mënyrën dhe mjetet e ndërtimit të rrëfimit, të tilla që përmes sekuencave, të arrijë te esenca tematike e karakterologjike e heroit, të krijoj personazhin, heroin tragjik, të cilin njëkohësisht recipienti do ta adhurojë, mëshirojë (adhurim për shkak të mëshirës) dhe do ta urrejë, për shkak se ndonjëherë ta kujton kryepersonazhin e Steinbekut, tek romani “Njerëz dhe minj”, që është gati identik me personazhin e Dibrës, për nga botëkuptimi dhe papjekuria mendore. Bala, heroi tragjik i prozës moderne romanore “Legjenda e vetmisë”, nuk e lë lexuesin të qëndrojë indiferent, e ngacmon madje edhe kur s’bën asnjë veprim; dhe është ky një tragjizëm që tek ai është shfaqur që nga fëmijëria, madje që në ngjizje. Bala as e ka zgjedhur këtë tragjizëm, as ka ditur të dalë nga ky tunel i mbyllur i një fatpreri.

Tragjizmi i Balës, tek lexuesi do të zgjojë iritim dhe mëshirën njëkohësisht. Heroi tragjik i “Legjendës së vetmisë”, i vetmisë së madhe e të pakompromis, është artist i lindur, naiv, i kredhur në një ankth të pafundmë, ku do të humbasë edhe perceptimin si artist, dhe me këtë humbje ai shkëput të gjitha lidhjet me realitetin, me racionalen, me botën që e rrethon. Nga bota e të gjallëve ai ka iritim të thellë, urrejtje, sepse vetë ai realitet i pashpirt e ka mbyllur në zindanet e vetmisë, prandaj heroi vazhdimisht dialogon me atin e vdekur dhe me botën e sendeve që e rrethojnë. Në këtë tekst, përveç tjerash, ngrihet edhe problematika e artistit, ku Bala del edhe si prototip i artistit tragjik të fatit të panënshkruar nga ai.

Meqë sall i ati e ka dashur sinqerisht Balën, dhe e ka kuptuar sinqerisht atë, ai i drejtohet atij me pyetje dhe merr përgjigje nga ai, ku me sa duket Bala pikë mistike e mitike, mbështetëse per ekzistencën e bën babanë; due, në atë vetmi hazarde, rrënohet muri mes reales dhe ireales, krijohet një realitet i ri, i ëndërrt që përsëritet në gjumë dhe zgjuar, ku kryeheroi më s’është artist por qenie që ngadalë shndërrohet në hije dhe lëviz padukshëm. Bala e ushqen këtë ndjenjë, meqë më lehtë e përballon ekzistencën si hije. Dialogët me atin e vdekur janë të shkurtër, të cilët si një çast vetëtime shndërisin në errësirën e thellë të vetmisë. Bala tragjik, i poshtëruar nga injoranca e botës që e rrethon, dhe i braktisur, ka humbur orientimin në pyllin e errët të fatit/fatalitetit, prandaj edhe i shtron pyetje të atit, dhe merr përgjigje nga ai, kështu bota e të vdekurit dhe e të gjallit komunikojnë. Kjo është gjetja, me të cilën Bala e shmang mundësinë e vetëvrasjes dhe çmendurisë. Por edhe më tragjike se vdekja na del vetë jeta, sepse: “*Bala, tash, sheh veç terr./Përjashta./ Edhe brenda vetes.*” (F. 98)



Triniteti nënë-djalë-babë nuk është shpërbërë as me vdekjen e babait, as me martesën e nënës me gjaksin e burrit, por ai trinitet i shenjtë nuk ka ekzistuar, dhe nga mungesa e këtij triniteti Bala shndërrohet në personazhin më tragjik në letërsinë shqipe.

Një risi tjetër që do ta hasim është se autori në asnjë moment nuk është pjesë e ngjarjes si narrator e referues, dhe ngjarja ndërthuret pa ndërhyrjen emocionale të narratorit autor, të narratorit komentues, të narratorit personazh etj. Pra, autori faktikisht, fizikisht dhe emocionalisht është jashtë ngrehinës tekstore të romanit, prandaj tekstin e karakterizon një ftohtësi dhe indiferentizëm i çuditshëm. Autori vron nga largësia.

Edhe pse gjithçka, ndaj gjithçkaje sillet në një rreth të mbyllur indiferece e ftohtësie të padurueshme, kurrkund brenda tekstit aq gërryes nuk shfaqen shenja të pesimizmit e nihilizmit, me të cilat është tejngopur letërsia bashkëkohore edhe moderne, edhe postmoderne, që ndonjëherë ndodh si rrëshqitje.

I gjithë rrëfimi i dramës, (tragjedisë) që ndodh në Egobokë, topikë tanimë e njohur nga “Triumfi...” dhe “Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë” etj., kap një periudhë pak më shumë se 10 vjeçe. Drama, përveç ndërfitjeve të rralla të retrospektionit, që kapin fare pak hapësirë tekstore, kryesisht me ndonjë fjali, gjithnjë është narracion perspektiv, po e përsëris, gjithnjë me sintaksë të zgjedhur dhe me fuqi narrative. Risi në këtë tekst romanor na shfaqet edhe ajo se autori as nuk na e tregon ngjarjen, as

nuk jep komente mbi ngjarjet, ndodhitë, bëmat. Ky segment, pra kur autori është krejt jashtë tekstit, thurjes së rrjetit të teksturës narrative, haset kohëve të fundit në letërsinë bashkëkohore evropiane, por s’e kam hasur në letërsinë shqipe, përveçse tejet fragmentarisht.

PËRFUNDIM

Dhe, në fund, për romanin “Legjenda e vetmisë” nuk mund të themi se është kryevepër e Ridvan Dibrës, madje nuk guxojmë të themi pa një studim serioz të të gjithë opusit, por pa hezitim, mund të pohojmë se romani “Legjenda e vetmisë” është vepër romanore e shkruar krejtësisht ndryshe, që tregon përkushtimin dhe guximin krijues të autorit kërkimtar.

Nëse autori këtë e ka pasur qëllim, padyshim që këtë ia ka arritur. Madje, edhe në qoftë së Ridvan Dibra ka bashkuar ndonjë elemente të tekstit postromantik, modernist dhe ndonjë element shumë të rrallë postmodern, (lloj tekst që ka krijuar njëfarë klisheu në postmodernizëm, sidomos kur kemi të bëjmë me eklektizëm zhanresh) ai këtë nuk e ka bërë që të krijojë një eklektizëm drejtimesh a rrymash letrare, por përkundrazi, këtë e ka bërë me qëllim që të largohet sa më shumë nga tri drejtimet, dhe kështu të krijojë diçka të re në letërsinë shqipe. Tekefundit nga guximi i autorëve të ndryshëm, në kohë dhe hapësira të ndryshme, kanë lindur zhanret drejtimet, rrymat letrare, por, natyrisht, edhe kryeveprat.



MBI TRAGJEDINË E PAPËRFUNDUAR “HAJRIJA” TË ATË GJERGJ FISHTËS

Nga Zef Zorba

Përgatiti për botim: Andreas Dushi
Vepra e fundit e Atë Fishtës që u vu në skenë para se ai të shpallej i ndaluar ishte “Juda Makabé” me regji të Zef Zorbës, në përvjetorin XXXIII të pavarësisë. Ajo u dha në teatër për tre ditë deri kur, me urdhër direkt nga Mehmet Shehu, gjithçka u ndalua. Si për ironi të fatit, dekada më vonë, kur tanimë figura e Atë Gjergj Fishtës po konsolidonte vendin që i takonte në letërsinë shqipe, po Zef Zorba merr pjesë me një kumtesë në një ndër konferencat e para që mbahen për fratin e madh. Ajo kumtesë ruhet në arkivin personal të Zef Zorbës dhe botohet për të parën herë me dëshirën e vajzave të tij, Elena dhe Luçia.

Data “7 Fruer 1939” që gjindet në dorëshkrimin e tragjedisë “Hajrija” të nisur së shkruari nga Fishta është vështirë të përcaktohet. Në atë kohë, ai, edhe pse i mposhtur nga sëmundja (do të vdiste pak muaj më pas), rreket sërish me vazhdu prodhimtarinë letraro - artistike, edhe pse i varur e i zhgënjyer në ideat e veta patriotike e shoqërore nga rrjedhja e asoherashme e punëve në vendin tonë. Ose ndoshta për virtyt të instinktit ironik të vet (çka duket se i gëzojnë poetët) po parashikonte, i tmerruar e i pezmatuar, kobin e “7 –të Prillit”.

Sepse mbetet gjithmonë ajo që ka pasë kodifikuar Shelley:

“Poetët janë buritë që thërrasin për beteja, poetët janë ligjvënësit anonimë të botës”.

Dhe ai, si katapult për të tillë sulm shkallmues, si kurdoherë në mbrojtje të drejtësisë, do të zgjidhte mjetin më efikas e të preferuem: dramatikën, art të cilin e ka pasur kështjellë të pamposhtur e ngallënjyse gjithmonë. E për shumë arsye madje.

Së pari, dashuria e prirja që ka pasë vazhdimisht për skenën. Ai e ndjente në shpirt se prej një podi të tillë, tribunë objektivizmi estetik, mund të shpaloste pa cen subjektivizmin që i mufatej - hareshëm ose edhe kobshëm - me poliendrizmin e shpirtit të vet. Me sypar të hapun e shifte vetvehten, jo vetëm nismëtar

e flakërues idealesh e parimesh, por njëherit edhe personazh dialogues me popullin. E dëshmon këtë, jo vetëm prodhimtaria e tij e gjerë në dramatikë, por edhethurja teatrale që ndeshet rëndom edhe në gjinitë e tjera poetike të përqafuara prej tij. Ai deri një sonet satirik “lum i forti” e ndërton si bocet skenik me personazhet dialogues të emërtuar (jashtë metrikës) në krye të vargjeve – batutë. Së dyti, e kjo më kryesorja, e saktë se Fishta e ka ditur mirë sa virtuozyt e afërsi mbarthe në vete raporti audio - viziv me masën. Si predikator i shquar që ka qenë, e ka pasë të qartë se komunikimi shqisor është më emotiv e i frytshëm sesa raporti liberator “autor - lecites”, pavarësisht nga popullariteti

që mund të gezojë faqja e shkruar. Pse në fund të fundit leximi ka më tepër tipar akademik të kufizuar, kurse spektakli është kurdoherë asociativ. Prandaj Fishta kurdo që ka ndërre nevojën e një kuvendimi, referenduar në synim, i është drejtuar skenës. Qoftë për të fishkulluar të meta e dobësi, qoftë për të dënuar pa mëshirë mendësi e komplotime të poshtra, të ishin ato edhe nga “Fuqi të Mëdha”, që mizorisht po coptonin atdheun. “Juda Makabé” i shkruar në vorbullën e Luftës Ballkanike, bëhet akuzë aq e fuqishme, sa që At Gjergj Fishta, i turitur nga padrejtësitë, duke harruar petkun e vet fetar dhe virtytet theologjike, rrëshqet pasionalisht në blasfemi:

“ O Perëndi, a ndjeve?
Tradhëtarët na lanë pa atdhe
E Ti rrin e gjuen me rrfe
Lisat n’për male kot!”

Tri janë tragjeditë e Fishtës: “Juda Makabé”, “Ifgjinia” dhe “Hajrija”. Kjo e fundit, mjerisht e pambaruar, i janë gjetur e botuar vetëm dy aktet e para. Dy tragjeditë e para, sikundër edhe pjesa dërrmuese e veprave të tjera skenike të tija, kanë gëzuar mjaft herë skenat teatrale, kanë hasur aty miratim emotiv të gjithëmbarshëm, që pa frikë mund të konsiderohet kritikë popullore. S’ka pasë si të ndodhte kështu me «Hajrijen». Nga ana tjetër, «Hajrija» e Fishtës është mjaft pak e njohur edhe si lexim, megjithëse në dy aktet e botuara, shtrun e zbulon shumë veçori të spikatura estetike, si dhe mjaft për të qëmtuar mbi evolucionin poetik të autorit.

Për këtë arsye, por edhe për tiparin ultimativ të saj, duket me vend kufizimi te «Hajrija ». Do të dëshironim që këto pak fjalë të vlenin sadopak për një këndvështrim tjetër të artit të Fishtës, qoftë ky edhe i karakterit limitativ.

Edhe pse me folë për heterogjeninë e veprave teatrale të tija, ka rrezik me shkarë në kodifikime bibliografie e komentative që shpeshherë tingëllojnë pedante.

Porse edhe analiza spekulative mbi një vepër të papërfunduar i ka rreziqet e veta. Veçse edhe shmangiet mund të mënjanojnë, po të mos u largohemi treguesve të gjetur si dhe analogjive krahasimore. Mbase, na ndihmon këtu, ligji matematik i probabilitetit.

Mbështetje, madje edhe inkurajim, na jep kritika e përbotshme që dëndur merret edhe me vepra cunge e fragmentare, të trashëguara nga lashtësia. Kushedi pse, po kur lexoj dy aktet e ‘Hajrijes’, më vete mendja gjithmonë te “Skllavi” i papërfunduar i Mikelanxhelos, te rropatja e tij e stërmundimshme për t’u shkoqur prej gurit që e robëron.

Vështirësia për një gjykim panoramik mbi këtë tragjedi thellohet edhe ma tej, ngase, siç duket, s’është gjetur ndonjë skenë ose stesure paraprake e thurur nga autori. Të ketë humbur ajo bashkë me të tjera gjëra të vyera gjatë bastisjeve rrënimtare të kryera në Kuvendin



Nga e majta në të djathtë: Willi Kamsi, Kolec Çefa, Pjerin Deda, Zef Zorba, Gjon Shllaku me të shoqen Neta Shllaku, Ndrekë Luca dhe Luigj Martini.

Françeskan? Sepse s’është e besueshme që Fishta, i ballafaquar me një temë aq të harlisur, të ketë nisur redaktimin e tragjedisë në mënyrë bashkëkohore, pa pasë hartuar paraprakisht tërë zhvillimin psikologjik e skenik të veprës. Për një skemë të tillë, flasin projektimi i veprës në 5 akte, si dhe renditja në listën e vehtjeve të dramës të mjaft personazheve që nuk dalin në skenë në dy aktet e para të tragjedisë.

Nga ana tjetër, tregues të tjerë analogjikë, mbase na hapin rrugë për të gjykuar mbi veprën e sidomos mbi autorin vetë, qoftë edhe nëse tani i mertisur nga një vel trishtimi, por gjithsesi i kordinuar si gjithmonë te moduli i vet poetik.

Në dy tragjeditë e tjera (sikurse te “Lahuta”) protagonist i mirëfilltë përshkues është ideja e lirisë e pavarësisë dhe personazhet të gjithë - duke ruajtur identitetin e vet - shërbejnë për ecjen zhvillimore, te “Hajrija”, drama e tragjedia thelbësisht subjektive është njëkohësisht e egërsisht objektive. Ajo, travajimet e veta, i flakëron dhunshëm kundër mjedisëve, shoqërisë, kundër mykurive e përçudnimeve që e ngujojnë.

S’ka dyshim që Fishta të jetë njohur me mitin e Medeas nëpërmjet veprave të Euripidit, Senekës, Kornejit e sa e sa dramaturgëve të tjerë, që janë marrë me këtë subjekt.

Për të gjithë ato, burim ka qenë mitologia greke: Medea e tradhëtuar prej burrit të vet - Jasonit, hero i Argonautëve - hakmerret duke mbytur fëmijët që ka pasë me të.

Pra, pak a shumë të gjithë ato Medea kanë një bosht erotik të përçudnuar nga xhelozia. Kurse “Hajrija” e Fishtës nuk ngacmohet nga e tillë ndjenjë e sidomos s’është mitologjike. Ajo është historike, e martuar në një mjedis amoral e çnjerëzor. Autori s’na ka lënë shtjellimin psikologjik të personazhit, por mund ta imagjinojmë atë mjaft mirë. Duke njohur personazhet e tjera femërore të Fishtës (Tringa, Ifgjenia, Motra e Avdisë, Ferina etj.), e sidomos duke i ditur bindjet e tija të mbështetuna fuqimisht në eskatologjinë theologjike, por edhe në filologjinë zakonore, na lejohet të supozojmë se “Hajrija” e Fishtës është fundamentalisht humane, edhe pse e rrasur në infanticid nga pabesia e zvetëtimi, ku e kanë katandisur rrebeshet.

Ndoshta nga ndikimi i Molierit që “Tartufin” e neveritshëm e nxjerr në skenë vetëm në aktin e tretë e mbrapa, edhe Fishta, Hajrijen nuk e paraqet në dy aktet e para. Por ngurrimi i Fishtës është dhimbja për personazhin, e cila do të jetë dinjitoze e fisnike edhe në krim. E këtë tipar, ajo duhet ta konfirmojë edhe në katarsin sublimativ të vetëvrasjes (e thotë këtë edhe folklori e s’do mend që Fishta do të jetë bazue mbi këtë). Kurse infanticida mitike, Medea, mbijeton e madje vazhdon rrugën e vet erotike e kriminale.

Një tjetër veçori për t’u rievluar është raporti krejt specifik “vëlla – motër” që vërehet në literaturën tonë edhe gojore e që shpesh e kemi takuar të gjithë në mesin tonë deri në ditët e sotme. Antigona e Sofokliut ngre krye kundër tiranisë e diktaturës edhe me vetëflijim, kurse Hajrija shkon më tutje, shumë më tutje.

Pastaj, gjuhëtarë të shquar na mësojnë, se ndërsa në gjuhët e tjera indoeuropiane nga rrënja sankriste “ma” kanë ardhur termat: motër, matter, mat, madher, në shqipe termi është tjetërsuar në substantivizëm “motër”. Kjo mund të ketë ndodhur nga zhvillimet demografike e klanore, por mbase s’është guxim të menduarit që në kodin gjenetik të femrës shqiptare të jetë i tiparizuar ky dualizëm raportativ: nënë - motër”. Si rrjedhojë, mund të afirmohet se Hajrijes i kanë tradhëtuar e vrarë vëllezër e bij, njëheri.

E prej kësaj, s’është i vështirë dallimi me zemrën e brengosur të poetit, kërkimi i një shtegu për të përligjur, në mos etnikisht, protagonisten fatzezë e për t’ia drejtuar rrufetë e veta çmoralizuesve të kombit.

E këtë na e pasqyron ma së miri me ravijëzimet e mjedisit amoral dhe të personazheve kriminelë e çnjerëzorë të dy akteve të para, përgjegjës këto për tragjedinë e Hajrijes e të kombit të robnuar e të nëpërkëmbur.

Mos ai t’i ketë parë ata prapë të ngrysyra e gjithnjë të thëngjillosura dhe pas njëzet e shtatë vjetësh pavarësie aq fort të dihatut dikur?

E u rrek t’i gjuante me rrfe!

Shkodër, më 1.10.1991

ZOJA E SHKODRËS NË DY POEZI

Kisha Katolike përkujton me 18 tetor vigjilien e festës së “Zojës së Shkodrës”, pajtores së gjithë Shqipërisë. Historia e saj lidhet me ikjen e pashpjegueshme në 1467 të një afresku ku paraqitet Zoja e Bekuar (Shën Mëria) me Jezusin fëmijë nga një kishë buzë Kalasë së Shkodrës, kur osmanët po afroheshin për ta pushtuar qytetin. Ajo u vendos në Gjenacano të Italisë ku gjendet akoma dhe sot. Ky moment është paraqitur nga dhjetra piktorë, si Kolë Idromeno, Lin Delia e deri edhe Lekë Tasi. Historia e kësaj ngjarjeje shpjegohet më së miri nga Italo Sarro në librin “Zoja e Këshillit të Mirë: historia e një shtegtimi të jashtëzakonshëm”, përkthyer nga Ardian Ndreca dhe botuar në shqip në 2017.

Shumë poetë të veriut i kushtuan poezi Zojës, disa syresh edhe si lutje për rikthimin e saj në Shkodër. Më poshtë po paraqesim dy pre tyre, njërën të shkruar nga Luigj Gurakuqi dhe tjetrën nga Atë Gjergj Fishta:

Dallëndyshja u kthye LUIGJ GURAKUQI

Gjatë komunizmit, vargjet e undit të kësaj poezie u hoqën, duke lënë në të vetëm motivin e mallit për atdheun, të shprehur nëpërmjet dallëndyshes, simbol shumë i përhapur në poezinë e asaj kohe.

Ti dallndyshën porosite,
Vendin tand me shkue me e pá,
Nepër Shkodër me shetitun,
Mbi vorr t’bab’s e t’nans me kjá,
N’ shkoll, n’ shpi tande ‘i herë m’u ndalë,
Me miq t’ motshëm m’u përfalë.
Erdh njimend, e nepër Shkodër
Shum kërkoi tuj fluturue,
Rrugs, n’ livadhe, n’ mal e n’ kodër,
Me kang t’vet na ka gazmue,
N’ fush t’ Rrmajit asht ndalue,
E mbi vorre ka vajtue.
Në prendverë ktej porsa mbrriini



Miqve tu i u fal me shndet,
Nepër shkollë, n’për kisha hini,
Me t’a hiek at kasavet,
E n’ shpi t’ vjetër ku ke le
Ka godit’ çerdhen e re.
Por kur kthej, me t’than a diti
Miqt, qytetin, punt si i la?
Para sysh Shqypnin a t’ qiti?
A e harroi ndoj send beldà?
A t’ kallxoi gjithshka kish pamun?
Si mbi vorre kishte kjamun?
Po prej prindsh ndoj shndet, ndoj fjalë,
Ndoj bekim a t’a ka pru?
Mbi rras’ t’ tyne kur u ndal,
Ndoj tub’ lule a e kish vu?
T’ zezat t’ona a t’i kallxoi?
Me kang’ t’ vet a t’i diftoi?
Shkodrën brengat e kan marrë,
Tjetër s’ndin veç gjamë e ankime,
Ma shpesh shifen se nej par
Gjaksi t’ mrapshta e turbullime.
S’ ka mbet’ gja pa u çoroditë,
Ma fort prangat na jan rritë!
Por ani, Zojën e kena,
Qi me dije na i shin lott,
Në Të, na t’vorfnit pshtetun jena,
Na ruen Zoja e na del zot!
Varrën tonë na e ankon
Si bylbyli kur gjimon!
Mir’ po shoh se ke shum mall
Për me u gjet’ njiher’ n’ Shqipni.
Ik pra e eja për të gjall
Me miq tu m’u knaq’, m’u ngi.
Eja vetë Zojën m’e pa,
Eja vetë n’ Rmaj me kja!

Zoja Shkodrës - Shkodra e Zojës ATË GJERGJ FISHTA

Zoja e Shkodrës
Kúr permbrenda atij Tempullit të rí,
Mue per nen dollma t’Rozafatit true,
N’gjúj shoh Shkodranin ulë me pervújtní,
M’bjen n’mend se Zoja e Shkodres më thonë mue.
E kúr per rreth e qark t’elternet t’mí,
Si stina e bukur t’nise me lulzue,
Fmín e Shkodranit ndiej tue m’kndue n’brohrí,
Vedin Shkodrane m’ kandet me e kujtue
Por edhe atë herë, po, kúr Shkodrani t’kajë
E t’ dnesë nder t’ vshtira, neper t’ cillat jeta
Ati i pershkohet, syt mue m’mbushen m’vajë,
E askurr nuk lâ pingul që Shkodren zhgjeta
E mnís s’ qiellës t’a shinojë, perse e verteta
Ësht kjo: qi Shkodra â’ emja e un e sajë.

Shkodra e Zojës
Atë botë mbi Shkoder kúr mâ i bukur dielli
Ndritte, e larg nâmi ksajë mbi tokë kumote,
Perpara elterit t’And Shkodrani fielli
Vîte, e Ty lavde me harë t’këndote.
E kúr mbi Shkoder xú m’u muzgun qielli
E per tē t’vshtira m’u endun stinë e mote,
Me Ty Shkodrani zëmren prap e kthielli,
Kah gurt e lterit t’And me lot rigote.
Por edhe sod Shkodra pshtjellë është n’ zí
E jeten si n’nji vorr ajo është tue shkue,
Shkodrani Ty po t’ ngrehë nji tempull t’ rí.
A ‘i mend, prá, o Zojë, se doret ké me lshue
Shqipninë e mjerë, e se edhe s’ke me ndí
Dhimbë për Shkodrani, kurr qi s’t’ ka harrue?

Zambak të argjendte

poezi nga

LOUISE GLÜCK

Shqipëroi: Roland Gjoza

ZAMBAK TË ARGJENDTË

Netët janë të freskëta përsëri si netët
e pranverës së hershme dhe përsëri është qetësi.
Mos
nuk të pëlqen të flasim? Ne jemi
vetëm fillikat; nuk kemi ndonjë shkak për të
heshtur.

Nuk e shikon; mbi kopsht po ngrihet hëna e plotë
Nuk kam për ta parë më këtë hënë të plotë.

Në pranverë, kur hëna ngrihet, të duket se
koha është e pafundme. Lulet e borës
hapen dhe mbyllen, pareshtur
bien fara panjash në dritën e zbehtë.
Më e bardhë se e bardha hëna ngrihet mbi
mënshtekna.
Dhe në shtegun ku pemët ndahen
narciset e parë, në dritën e hënës
me një të gjelbër argjendi të butë

Ne kemi kaq kohë bashkë dhe kemi mbërritur në
fund
dhe tani kemi frikë nga fundi. Këto net nuk jam më
pak e sigurtë.
Unë e di çfarë do të thotë fund. Sigurisht dhe ju që
keni patur
një burrë.

Pas qarjes së parë
A nuk të duket gëzimi si frikë?



FLUTURA

Shiko, ja, një flutur
Nuk do t'i thuash një dëshirë?

Nuk do t'i thuash një dëshirë fluturës?

Bëje, pra.
Nuk do t'i thuash një?

Po.

Nuk quhet.



KUJTIM I HERSHËM

Dikur, më rrahën.
Jetoja
Vetëm për t'u hakmarrë
Kundër babait, jo
Për atë që ai ishte-
Po për veten; që nga koha e hershme

E fëmijërisë, kur mendoja se
Një dhimbje e tillë
Do të thoshte se nuk më donin.

Dhe unë i doja.



FANTAZI

Do t'iu tregoj diçka; çdo ditë
Vdesin njerëz.
Dhe ky është vetëm fillimi.

Çdo ditë në shtëpitë e varrimit vijnë të veja të reja
Dhe jetimë të rinj
Ata ulen me duar të kryqëzuara
Duke vrarë mendjen se çdo të bëjnë tani

Pastaj ata shkojnë ne varrezë, disa prej tyre
Për herë të parë.
Ata kanë frikë nga të qarat
Dhe nganjëherë nga heshtja e rëndë
Dikush iu pëshpërit se ç'duhet të bëjnë

Të thonë ca fjalë, te hedhin një dorë dhe
Mbi varr.

Pas kësaj të gjithë kthehen në shtëpi
E cila papritur mbushet me vizitorë
E veja ulet në divan, hijerëndë
të gjithë shtyhen t'i afrohen
herë i shtrëngojnë dorën, herë e përqafojnë

Ajo përpiqet të gjejë diçka për t'iu thënë
faleminderit, faleminderit që erdhët

Por me zemër do që ata t'ia mbathin sa më parë

Ajo gjithashtu do që të kthehet përsëri në varrezë
Në spital, te dhoma e të sëmurëve
Ajo e di
Që kjo është e pamundur
Por kjo është shpresa e vetme që i ka mbetur
Të kthehet prapa
Vetëm pak,
Jo larg nga matesa, puthja e parë



IRIS I EGËR

Në fund të vuajtjeve të mia
një derë.

Dëgjomë; atë që ti quan vdekje
kujtoj

Mbi kokën time, zhurmë, degët e pishës përplasen
dhe asgjë tjetër. Dielli i ftohtë
drithëron mbi sipërfaqen e thatë

Është e tmerrshme të mbijetosh
si ndërgjegje
varrosur në tokën e errët

Dhe gjithçka mbaron; ajo që ke më tepër frikë
është një shpirt i paaftë
për të thënë diçka.



Dhe papritur e sheh veten duke u përkulur drejt tokës së gurtë. Dhe iu ngjan kështu zogjve që zhyten pingulthi në ca shkurre të vogla

Ty, që s'të kujtohet
asnjë çast nga bota tjetër
po të them se mund të flas përsëri; sidoqoftë
kthimet prej harresave kthehen
për të gjetur një zë;

Nga qendra e jetës sime vijnë
nje burim i madh, blu i thellë
dhe hije në ujin e detit të kaltër



EROS

Tërhoqa karrigen pranë dritares së hotelit për të
parë shiun
Ishte një lloj ëndrre apo transi
dashurie dhe ende
nuk doja asgjë.

Më dukej e kotë të të prekja apo të shikoja ty
përsëri
të vetmet gjëra që doja tani;
dhoma, flokët, zhurma e shiut që bie
pa pushuar asnjëherë në natën e ngrohtë të
pranverës

Nuk doja asgjë tjetër; isha e mbushur me ndjesi
zemra paskish qenë shumë e vogël, fare pak u desh
për ta bërë të madhe përsëri
vështroja shiun që binte me shkulm e kumb mbi
qytetin e errët

Ti nuk doje t'ia dije për asgjë. Unë bëra po ato gjëra
që bëja në ditën me dritë, u çlirova prej vetvetes
lëvizja nëpër dhomë si një somnambul

Kaq ishte, e mjaftueshme për mua, ti diku jashtë
meje
pak ditë në një qytet të çuditshëm
një bisedë, një prekje dore
dhe pastaj, heqja e unazës së martesës

Dhe ajo që doja; të isha lakuriq.



ZAMBAKË TË BARDHË

Një burrë dhe një grua mund të krijojnë
një kopsht midis tyre
si një shtrat me yje dhe
të ecin ngadalë në mbrëmjen e verës
po mbrëmja bëhet e akullt
nga ftohtësia e tyre; dhe të gjitha
mund të përfundojnë këtu,
të shkatërrohen në çast. Të gjitha, të gjitha
mund të humbasin, përmes ajrit plot aromë.
kolonave të ngushta
që ngrihen të pavlefshme dhe përtej
një det lulëkuqesh që çmendet

Pusho, i dashur. Nuk ka rëndësi për mua
sa vera jetova për t'i kthyer sërish;
këtë verë kemi hyrë në përjetësi.
Ndiej dy duart e tua
më varros për të çliruar shkëlqimin e tyre



VENDIMI I ODISESË

Njeriu i madh i kthehu shpinën ishullit

Tani ai nuk do të vdesë në parajsë.
Nuk do të dëgjojë përsëri



lahutat e parajsës në mes të ullinjve
pranë pellgjeve të kthjellët nën qiparisa.

Koha
tani fillon dhe ai dëgjon
pulsin në të cilin rreh deti me aventura
deti në agim kur tundimi është më i fortë

Çfarë na ka sjellë këtu
sërish do të na largojë; anijet tona
lëkunden në ujin me ngjyra të limanit

Tani magjia ka marrë fund.

Jeta e tij u kthye mbrapsht
Vetëm deti shkon përpara



MESNATË

Yjet janë të butë si lulet dhe kaq afër
Kodrat rrjeta hijesh janë, tirren ngadalë
Asnjë gjethe, asnjë fije bar s'duket këtu
Të gjitha janë shkrirë në një

Asnjë rreze hëne nuk e pret ajrin; një dritë safiri
bën rrotullime të plogëta
Dhe rrëshqet përsëri për t'u platitur.

Nuk ka asgjë që të bëjë majë në këtë mesnatë
të cilën e kam në gjoksin tim



KALI

Çfarë të jep kali
që unë s'ta jap dot?

Të shoh kur je vetëm
kur kalëron përmes fushave pas punishteve të
qumështit
kur duart e tua varrosen
në krifat e errëta të pelës.

Atëherë e kuptoj çfarë fshihet pas heshtjes tënde,
përbuzje, urrejtje për mua, për martesën.

Ende
ti dëshiron që unë të të ngacmoj; ti klith si i
çmendur
si nuset kur qajnë; unë zbuloj ato çaste
se në trupin tënd nuk ka fëmijë.

Çfare ka atje?
Asgjë, mendoj.
Vetëm dëshira e ethshme
të vdes para se të vdes.

Në ëndërr unë të shoh kur je vetëm
kur kalëron fushave e bokërrimave, kur
zbret nga kali; ju të dy udhëtoni së bashku
në errësirë, pa hije.

Ndiej si vini drejt meje
sepse ju shkoni kudo
jeni zotër të fushave dhe të natës.

Më shiko në sy
ti mendon se nuk të kuptoj?
Ç'mund të jetë kafsha?
Një fragment që kalon dhe asgjë.



LULE BORE

A e di çfarë isha, si jetoja? Ti e di
çfarë është dëshpërimi; kështu që
dimri duhet të ketë kuptim për ty.

Nuk shpresoja të mbijetoja
toka më merrte frymën
nuk shpresoja
të zgjohesha përsëri; të ndieja
lagështirën e tokës në trupin tim
të jepja shenja jete përsëri, duke u kujtuar
pas kaq kohësh të çelem
në dritën e ftohtë
të pranverës së hershme.

Frikë, po me ty sërish
duke qarë rrezikoj gëzimin

në erën e ftohtë të botës së re

1.
Jeta është fat dhe tragjedi, me sfida e ngjarje të njohura dhe të panjohura.
Me dashuri.
Në anën tjetër, me mashtrime.
Për këtë faqe të historisë së anatomisë, për moralin e kam edhe një pyetje:
Përveç premtimit edhe diçka tjetër.
Jashtë kontrollit kthehem rrotull e rrotull të shohim se çka kemi humbur.
S'është e thënë se mashtrimet janë për ta gjetur veten.
Ku jemi?
Pse të shqetësohemi?
Mund të mendojmë gjithçka.
Dhe, të ardhmen ta shohim ëndrra.
Pushojmë pak.
Ku të ndalemi?
Ku të shkojmë?
Jemi në kohën e pamjeve ku çdokush mundohet të përfitojë diçka, me grabitje e kënaqësi të frikshme.
Ndonjëherë mendojmë se kështu ka qenë gjithmonë.
Për historinë e pashkruar në botë, ka shumë vetmi.

2.
Po thonë, me matematikë çdokush e gjen veten.
Shohin gjëra që nuk i kemi parë.
Njerëzit flasin.
Ashtu si jemi, një pëllëmbë më thellë hyjmë në ëndrrat e njëri tjetrit.
Për të gjetur diçka të fshehur.
Gjithmonë ka qenë gjithmonë.
Nuk duhet të jemi kot.
Kush kërkon, shkon për t'u rrëfyer.
Më larg se e kaluara.
Deri në një pikë që na e kthen kokën mbrapa.
Me shejtanin nëpër dynja.
Para e mbrapa.
Majtas e djathtas.
Të gëzuar e të trishtuar.
Si mund ta gjej një mik?
T'i them mirëditë vetes.
Krizat moderne, si duket, nuk po na sheh si po na mban kjo tokë.
As kohën kurrkush nuk po e kupton.
Kënd ta pyes, ku po shkojmë.
Nuk ka kthim prapa.
Njeriu, duke thënë jo i lanë mëkatet.
Për botën e kësaj bote.
Ka diçka që nuk shkon.
Pse të shqetësohemi?
Asgjë s'mund ta themi drejtpërdrejt.
Njeriu ka mbetur vetëm.
Për botën e kësaj bote ka diçka që nuk shkon.
Ç'do të thotë kjo?
Për ta parë veten në pasqyrë, në emër të Zotit.
Në Pesë rrugët e Zotit.
Hëna si hëna e njeriu si njeriu për një lojë të hesapeve të veta, tregtari i flamujve tri herë e vret dashurinë.
Është vështirë për ta kuptuar.
Dëshira është botë e fshehur.
Shpejtësia e dritës nuk ka më rregulla.
Nëpër terr mos e mendoni veten qendër të botës.
Patriotizmi i rrejshëm po bëhet profesion.
Keqpërdorimi nuk bëhet hesap.
-Kush je ti nën maskë? – hijen e zgjatur e pyeta.
-A s'po e sheh se çfarë patrioti jam?!

-Hapi sytë mirë.
-Hajt histori, hajt, deri ku, as ti s'e din.

RRËFIMI I FATIT TË KEQ

Rexhep FERRI

Njerëzit me dy fytyra,, tri palë letra i kanë në xhep.
Për ta shkatërruar edhe planetin, kanë folur edhe dje.
Historia qeshi.
At Gjergj Fishta, nga kodra në kodër tha:
“O kaçel kape lahutën... nuk mbajmë zi pa dalë fare!”

3.
Çfarë jete e maskuar po na pret.
Nuk mund të ikim nga kjo çmenduri.
Kurrë nuk kemi qenë më të pasur.
Kemi përvetësuar shumë natyra dhe kemi zbritur deri te dilemat: çka është bukuria e jetës?
Maskat filluan të qeshin.
Mos më ik larg.
Ta lëmë anash hapin e ngjyrës që kalon në ngjyrën e tjetër.
Njeriu çfarë vlere ka.
Koha është diçka tjetër.
Edhe loja e të gjitha lojërave diçka tjetër.
Premtimi, premtimi.
Fjala, fjalë.
Nuk ndryshon.
Mund ta vrasim.
Jam në hënë.
Një studente që e kishte në dorë një letër krejtësisht të bardhë në dorë më pyeti:
-Profesor, shikoje vizatimin tim.
Unë për ta shpëtuar të bukurën heshta.
Ajo me hapin e sorkadhes vjen më afër dhe thotë:
“Pak gjëra dua për jetën. Me qenë yll. Me ra prej qiellit. Me t'u plotësuar një dëshirë”.
Për të njohur dimensionin e jetës, kuptimin e të kuptuarit nëpër

ndryshime, për rregullat e jetës si realitet.
Përgjigjen që nuk e kuptoj e lash pak më larg.
Diçka tragjike derdhet në det.

4.
Mendoja se kush jam.
Për asgjë nuk kam përgjigje.
Për dy mijë vjet të shkuara, gjithsesi të pakuptueshme.
Tani po shihemi më mirë se kush është njeriu.
Edhe pse shijet po ndryshojnë.
Historinë e pa shkruar e kemi.
Pa kërkesa.
Pa fyerje.
Në emër të tokës.
Në emër të kohës.
Çfarë do të bëjmë vetëm?
Kujt t'i kërkojmë falje?
Zotit apo Njeriut.
Për shenjtërimin, më falni.
Shekulli në të cilin po jetojmë, është shekulli i shumë gjurmëve, kërkesave, mashtrimeve, vrasjeve.
I vrasjeve për të cilat s'ka dëshmitarë.
Historikisht varrezat humbin.
Jetë është një shfaqje teatri.

5.
Për të shpëtuar nga numri magjik, ende nuk e dimë se kush jemi.
Qëllimi është për një jetë tjetër.
Me helmin e gjarprit puthemi.
Mos qani!
Mos qeshni!
Mos besoni!
Me një bekim në heshtje.
Kur nuk ndodh asgjë.
Bukuria është një mallkim.
Me një dritë jetëshkurtër.
Kur i humbim mundësitë.

Për nesër, kur bëhet vonë, marrim një mbidozë.
Kemi diçka që duam.
Mund të flasim për rrezikun.
Kontrollojeni trurin.
Takohemi.
Si duket, s'e ka fajin truri.
Çka është historia?
Si të ishte e dikujt tjetër.
Gjarpri i shërimit e di ku shkojmë.
Si marrim frymë.
Jo ashtu, po kështu.
Me do sadriazema që nuk e dinë se çka është liria.
Tani ajo shihet nga larg dhe nga afër.

6.
Kërkesat e kohës së tashme s'kanë se ku të shkojnë më larg.
Trimat kanë vdekur.
Mund ta kuptoni.
Jeta vlen për çdo gjë.
Kur nuk ka pyetje: kush jemi dhe ku po shkojmë...
Nëpër shkretëtirë e kuptojmë frikën.
Për më shumë nuk di.
Kurrkush nuk e ka mbyllur këtë histori.
Për ideologji dhe interesa personale, po na vjen një ditë që kërkon të bëjmë diçka.
Për një qetësi të thellë, mbylli sytë dhe prit.
Duhet të zbresim nga qielli.
Për Rrëfimin e Fatit të Keq deri në fund më ke.
Nuk ka dritë.
Nuk më sheh as hëna.
Dua të mendoj se kush jam.
Kam frikë edhe kur nuk kam frikë.
Si gjithmonë jemi në kohën e tregtarëve të flamujve.
Thonë se janë patrioti, besa Zotit janë tregtarë flamujsh...

7.
Në kërkim të vetvetes më vjen edhe të rrezikoj.
Le të shkojë si të shkojë.
Kemi arritur deri aty ku nuk e dimë se kush jemi e pse jemi.
Të keqen na e solli era.
Ta shohim si po shkon jeta.
Pritni pak.
Po vërehet se po na mungon besimi.
Kjo vlen për të gjithë.
Jeta është jetë, pak më shumë se fjalë.
Çaush Çaushi me dy alltia në brez shkoi te Gomari i Artë për ta pyetur si bëhet lufta.
Si jetohet pas luftës?
Kur jeta bëhet e pakuptueshme.
Nuk kemi më me çka të krahasohemi.
Në çdo kohë për anën e errët të Hënës, ndoshta është e njëjta histori.
Pse jemi kaq të paqëndrueshëm.
Para pasqyrës, në shekullin tonë, për kombin e shtetin flitet në Pazar.
Drama është për zjarrin.
Ikni larg!
Historia e shkruar është e pa shkruar.
Mos e dëgjoni as mikun e as armikun.
Tani është koha ta shohim se kush jemi.
Për kohën e ardhshme shihemi më vonë.
Kam parë gjithçka.
Ta kisha një besim të pagabuar, nuk do të kisha nevojë për orientim.
Çka mund të themi tjetër?
Prekeni Tokën.
Do të më kuptoni...



Një vend i pastër, i ndriçuar mirë

tregim nga

ERNEST
HEMINGWAY

[Hemingway] ka mpakur velin ndarës mes letërsisë dhe jetës; gjë për të cilën çdo shkrimtar orvatet. A e keni lexuar 'Një vend i pastër, i ndriçuar mirë'?... Është mjeshtëror. Ç'është e vërteta, bëhet fjalë për një ndër tregimet më të mirë që janë shkruar ndonjëherë."

James JOYCE

Ishte vonë dhe në kafene nuk kish mbetur njeri përveç një plaku të ulur nën hijen e gjetheve të pemës që mbulonin ndriçimin elektrik. Gjatë ditës, rruga ishte e pluhurosur, por natën vesa e sheshonte pluhurin dhe plakut i pëlqente të ulej vonë pasi duke qenë shurdh, e ndjente dallimin tani që natën ish qetë. Dy kamerierët brenda kafenesë e dinin se plaku ishte pak i pirë; e pavarësisht se ai i përkiste sojit të klientëve të mbarë, ata dinin gjithashtu se po të pihej tepër plaku do të largohej pa paguar. E për këtë arsye nuk ia hiqnin sytë.

"Javën e kaluar desh të vriste veten," tha njëri kamerier.

"Pse?"

"Ish bërë helm."

"Për ç'arsye?"

"Për hiçgjë."

"Nga e di ti se për hiçgjë?"

"Se e ka kuletën plot."

Ata qenë të ulur bashkë në një tavolinë mbështetur ndanë murit ngjitur me derën e kafenesë dhe vështronin nga tarraca, atje ku tavolinat ishin të gjitha bosh përveç asaj ku ishte ulur plaku nën hijen e gjetheve të pemës që era zhvendosi lehtas. Një vajzë dhe një ushtar kaluan në rrugë. Ndriçimi i rrugës bëri që të shkëlqejë numri i tunxhtë mbi jakën e tij. Vajza nuk mbante shami në kokë dhe nxitonte krah tij.

"Kanë për ta gjetur rojet," tha njëri kamerier.

"E ç'rëndësi ka nëse ia arrin qëllimit që i ka vënë vetes?"

"Bën mirë të mos dalë rrugëve. Rojet do ta zënë. Kaluan këtu vetëm pesë minuta më parë."

Plaku i ulur në hije i ra pjatëzës me gotë. Kamerieri më i ri në moshë i vajti pranë.

"Çfarë do?"

Plaku i drejtoi shikimin. "Edhe një konjak," i tha.

"Do pihesh," i tha kamerieri. Plaku i drejtoi shikimin. Kamerieri u largua.

"Ka për të ndenjur gjithë natën," i tha shokut të vet të punës. "Po më zë gjumi tani. Kurrë nuk arrij të futem në shtrat para orës tre. Më mirë ta kish vrarë veten që javën e kaluar."

Kamerieri mori shishen e konjakut dhe një tjetër pjatëz prej banakut brenda kafenesë dhe u drejtua jashtë për te tavolina e plakut. Uli pjatëzën dhe mbushi gotën me konjak.

"Më mirë ta kishe vrarë veten që javën e kaluar," i tha plakut të shurdhër. Ky lëvizje gishtin e tij. "Edhe një çikë," tha. Kamerieri hodhi aq sa konjaku doli nga buzët e gotës dhe rrëshqiti mbi pjatëzën në majë të grumbullit. "Faleminderit," tha plaku. Kamerieri ktheu shishen brenda kafenesë. Pastaj u ul sërish në tavolinë me shokun e tij të punës.

"Tani është pirë," tha.

"I pirë është përnatë."

"Pse deshi të vriste veten?"

"Nga ta di unë?"

"Po në ç'mënyrë?"

"Vari veten me litar."

"Po kush e shpëtoi?"

"Mbesa."

"Po ç'e shtyu?"

"Meraku për shpirtin e tij."

"Sa para ka ai?"

"Sa të duash."

"Duhet t'i ketë nja tetëdhjetë vjet."

"Sidoqoftë, po themi se ishte tetëdhjetë vjeç."

"Do desha shumë që të ikte në shtëpi. Kurrë nuk arrij të hyj në shtrat para orës tre. Orë për t'u futur në shtrat është ajo?"

"Ai rri zgjuar pasi i pëlqen kjo gjë."

"Ai është fillikat. Unë jo. Kam grua që më pret në shtrat."

"Edhe ai kishte një grua dikur."

"Një grua nuk do i bënte më punë tani."

"Që ç'ke me të. Një grua do i bënte punë".

"Kujdeset mbesa për të. Ti the se qe ajo që e shpëtoi."

"E di."

"Nuk do desha kurrë të isha aq plak. Një plak të ngjall ndot."

"Jo gjithmonë. Ky është plak i pastër. Pi pa u ndotur. Madje dhe tani që është i pirë. Shihe."

"As ma ndjen ta shoh. Dua vetëm që të shkojë në shtëpi të vet. Ai as që e vret mendjen për ata që kanë punë."

Plaku hoqi sytë nga gota dhe hodhi një vështrim përgjatë sheshit, pastaj pa nga kamerierët.


"Një tjetër konjak," tha, me gishtin drejtuar gotës. Kamerieri që e kishte me ngut i vajti pranë.

"Mbaroi," ia ktheu, duke ngrënë fjalët siç përpiqen debilët kur duan të shpjegohen para të dehurve apo të huajve. "Kaq sonte. Mbyllur tani."

"Edhe një," tha plaku.

"Jo. Mbaroi." Kamerieri fshi u anët e tavolinës me një pecetë dhe tundi kokën në shenjë mohimi.

Plaku u ngrit në këmbë, numëroi pjatëzat me ngadalë, nxori një kuletë lëkure nga xhepi dhe pagoi për pijet, duke lënë gjysmë *peseta* bakshish. Kamerieri e pa



tek dilte në rrugë, atë burrë plak që ecte duke u lëkundur, por me dinjitet.

"Pse s'e le të qëndronte dhe të pinte?" pyeti kamerieri që s'e kishte me ngut. Ata po mbyllnin qepenat. "Nuk ka vajtur dy e gjysmë."

"Dua të kthehem në shtëpi dhe të futem në shtrat."

"Ç'vlerë ka një orë më shumë?"

"Për mua ka më vlerë se për atë."

"Një orë nuk bën ndryshim."

"Flet si të ishte vetë plak. Ai mund të blejë një shishe dhe ta pijë në shtëpi."

"Nuk është e njëjta gjë."

"Jo, nuk është," pranoi kamerieri me grua. Nuk donte të tregohej i padrejtë. Veçse e kishte me ngut.

"Po ti? Nuk ke frikë të kthehesh në shtëpi përpara orarit të zakonshëm?"

"Mos do të më fyesh?"

"Jo, *hombre*, thjesht po bëja shaka".

"Jo," tha kamerieri që e kishte me ngut, teksa çohej pasi kishte ulur qepenat. "Kam besim tek vetja. Jam plot me besim te vetja."

"Ke rininë, ke besimin te vetja, ke dhe një zanat," tha kamerieri më në moshë. "I ke të gjitha."

"Po ty çfarë të mungon?"

"Të gjitha veç zanatit."

"I ke të gjitha njësoj si unë."

"Jo. Nuk kam pasur kurrë besim te vetja dhe nuk jam i ri."

"Ec tani. Mjaft fole së koti dhe vëri drynin."

"I përkas atyre që u pëlqen të rrinë deri vonë në kafene," tha kamerieri më në moshë. "Bashkë me ata që nuk duan të shkojnë në shtrat. Bashkë me ata që kanë nevojë për ndriçim natën."

"Dua të shkoj në shtëpi dhe të futem në shtrat."

"Unë dhe ti jemi prej dy sojesh të ndryshëm," tha kamerieri më i moshuar. Ai ishte veshur dhe bërë gati për të vajtur në shtëpi. "Nuk është vetëm punë rinie dhe besimi te vetja, edhe pse këto janë gjëra shumë të bukura. Çdo natë unë ngurroj ta mbyll kafenenë pasi mund të jetë ndonjë që ka nevojë për të."

"*Hombre*, ka *bodegas* që rrinë hapur gjithë natën."

"Ti nuk po kupton. Kjo është një kafene e pastër dhe e këndshme. Me ndriçim të mirë. Ndriçimi është vërtet i kënaqshëm. Ka dhe hije degësh për më tepër."

"Natën e mirë," tha kamerieri më i ri në moshë.

"Natën e mirë," tha tjetri. Ndërsa mbyllte dritat, ai vazhdoi të bisedonte me veten. Ndriçimi sigurisht që ka rëndësi, por është e domosdoshme që vendi të jetë i pastër dhe i këndshëm. Muzikën s'ke ç'e do. Sigurisht që s'ke ç'e do. E as mund të rrish me dinjitet para një klubi pavarësisht se veç këtë mundësi të jep ajo orë e natës. Nga çfarë kishte frikë? Nuk ishte as frikë as droje. Ishte një hiç të cilin ai e njihje fare mirë. Ish veç një hiç dhe njeriu është një hiç po aq. Kaq ishte dhe ndriçimi ishte e vetmja gjë që nevojitej, si dhe njëfarë pastërtie dhe rregulli. Disa e jetonin nga brenda dhe kurrë nuk ia ndjenin praninë, por ai e dinte se gjithçka ish *nada y pues nada y nada y pues nada. Nada* jonë që je *nënada, nada* qoftë emri yt *nada* mbretëria jote u *nada* vullneti yt si në *nada* ashtu dhe në *nada. Nada* tonë të përditshme falna sot dhe *nada* tona siç u *nada* ne *nada* tanë dhe mos na *nada* në *nada*, por na çliro nga *nada; pues nada*. Të falemi hiç, hiçplot, hiçi është me ty. Ai buzëqeshi dhe mbajti hapin para një klubi që mbante ndezur makinën për bluarje me presion të kafes.

"Ç'do pish?" pyeti banakieri.

"*Nada*."

"*Otro loco mas*," tha banakieri dhe ktheu krahët.

"Një gotë të vogël," tha kamerieri.

Banakieri ia mbushi.

"Ndriçimi është vërtet i madh dhe i këndshëm, por klubi ka pluhur," tha kamerieri.

Banakieri e pa, por nuk u përgjigj. Ishte shumë vonë për të këmbyer fjalë.

"Do një tjetër *copita*?" pyeti banakieri.

"Jo, faleminderit," tha kamerieri dhe doli. Nuk i pëlqenin klube e *bodegas*. Një kafene e pastër dhe me ndriçim të mirë është tjetër gjë. Tani, pa e vrarë më shumë mendjen, do të shkonte në shtëpi, drejt e në dhomën e tij. Do shtrihej dhe pastaj, ndaj të gdhirë, do ta zinte gjumi. Në fund të fundit, thosh ai me vete, me gjasë është veç pagjumësi. Shumë duhet ta kenë.

[Përktheu nga origjinali: Edon Qesari]

NDËSHKIMI I NJË KRYEVEPRE TË LETËRSISË BOTERORE NGA KEQPËRKTHIMI

Nga Theodor Cico

Ka qenë një dëshirë e imja e kahershme për të parë se si janë përkthyer në shqip disa nga kryeveprat e letërsisë ruse, por që kanë edhe një vend të veçantë e të shquar në mbarë letërsinë botërore. Këtë herë po ndalemi te përkthimi në shqip i romanit “Krim dhe ndëshkim” të Fjodor Dostojevskit, botim i shtëpisë botuese “Fan Noli”. Vepra origjinale është përkthyer nga Mukades Mançe.

Qysh në faqet e para të përkthimit vihet re prirja e përkthyeses për t’i rrotulluar në mendjen e saj gjërat, për t’i marrë me mend, kur duhej të përkthente gjithçka me besnikëri dhe kuptimi del vetë. Pra, nuk mund të përkthehet duke u marrë me mend se ç’ka dashur të thotë autori dhe pastaj të hidhen në letër fjalitë dhe frazat e tij. Fjalët e autorit duheshin dhënë me besnikëri të madhe dhe, kuptohet, edhe me një mjeshtëri të lartë për tingëllimin e tyre sa më bukur në shqip. Kjo sepse bëhet fjalë jo për një vepër dosido, por për një prej veprave letrare më të famshme të të gjitha kohëve që, bashkë me romanin “Lufta dhe paqja” të Leon Tolstoit, bën pjesë në romanet ruse, të cilët hyjnë në fondin e artë të kësaj letërsie dhe të asaj botërore.

Qysh në fillim të përkthimit të romanit thuhet “Ishte fillimi i korrikut.” dhe vihet pikë. Pra ndërpritet mendimi i autorit, në një kohë që pika është në fund të paragrafit. Ndërpritet edhe një herë tjetër po ky paragraf me pikë, pra dy herë ndërpritet fraza, në vend që të vijonte ajo pa asnjë ndërprerje, siç e ka autori. Me ç’të drejtë bëhet kjo?! Në fakt romani nis me fjalët “Në fillim të korrikut...”, pra nuk mund të fillonte kurrsesi një vepër e tillë me “Ishte...”, se nuk kemi të bëjmë me një libër me përralla. Pastaj përmenden në këtë paragraf të parë rruga “S” dhe ura “K”. Do të ishte mirë të jepeshin disa shpjegime, siç ndodh në shumë variante të përkthimit të kësaj vepre në gjuhët e tjera. Kjo ka rëndësinë e vet sidomos për lexuesin. Fjala vjen rruga “S” është rruga “Stoljarnij”, ku banonte Dostojevskij kur shkruajti “Krim dhe ndëshkim”, kurse ura “K” është ura “Kokushkin” mbi kanalin Jekatjerininskij (sot Gribojedov).

Kjo që ndodh qysh në paragrafin e parë të përkthimit, haset kudo në vepër. Pra, vihet pikë, kur nuk duhet dhe hiqet pika që ka vënë autori, kur ajo duhet, shtohen fjalë, se kështu i duket e arsyeshme përkthyeses (si “se luan topi”, “bën mu”, “por puna është se”, “nuk dinte si të vepronte” etj.etj.), kalohet në kryeradhë, kur në tekst nuk është kryeradhë (“Në dimër një i njohuri i tij student” f.73 etj.), në disa raste nuk mbyllen saktë fjalët në kllapa, ose harrohet vënia e kllapave, kur ato janë në origjinal, përmenden emrat e personazheve në vend të përemrave, me të cilët ata jepen në kontekste të ndryshme, duke menduar se lexuesi mund t’i ngatërrojë gjërat, kur jo vetëm s’është nevoja, por s’ke as të drejtë ta bësh këtë etj. Ose fjalë me shkronja kursive të origjinalit nuk i gjejmë kështu në përkthim, pastaj bëhet edhe e kundërta, pra nënvizohen fjalë, kur s’janë të nënvizuara në roman (f.73 “çështjen” dhe “ngjarjes”).

Për të ilustruar këto që thamë më lart, po analizojmë disa momente të përkthimit, ngaqë nuk mund të analizojmë të gjithë paragrafët e veprës së përkthyer. F.7: Nuk është “Aty të riun e pushtonte një ndjesi frike, pështjellimi dhe turpi”, por “provonte një ndjenjë patologjike dhe frike, nga e cila i vinte turp dhe ngrysej në fytyrë.” Duke qenë se është prirja për të komentuar atë që thuhet në veprën origjinale, hasim në përkthim (f.8): “...por puna është se...”. Ku ka në roman thënie të tilla?! Aty thjesht pohohet: “Por të ndalej në shkallë dhe të dëgjonte dokrrat...”.

F.27: “netët që ai kishte kaluar në varkë” (jo, është “pesë netët” dhe jo në varkë, sepse “сенные барки” jane barka të sheshta prej bari të thatë që shërbejnë si ura të përkohshme) dhe “shishja e vodkës e boshatisur” (pse e boshatisur?!). “Ishte penduar që ishte futur në këtë pijetore.” Së pari, përsërit ishte, ishte dhe, së dyti, jo “Ishte penduar”, por “i vinte inat ... (досадовал)”. Nuk thotë “në këtë pijetore”, por “зашёл сюда”, pra ngaqë hyri në këtë vend.

F.49: “Letra e nënës i ra Raskolnikovit si bombë.” S’është nevoja të thotë Raskolnikovit, nuk e ka në tekst, ku thuhet “Письмо матери его измучило.” Pra atë e

mundoi dhe jo i ra si bombë, se letrën Raskolnikov i kishte lexuar tashmë dhe nuk është se po e lexonte tani, në këtë çast. Pastaj vijon: “Lidhur me çështjen kryesore që trajtohej në letër, ai s’kishte pikë dyshimi, madje as kur ishte duke e lexuar letrën.” Nuk thuhet “çështjen”, as “kryesore”, por “Për sa i përket pikës (пункта) më kryesore” dhe jo “s’kishte pikë dyshimi”, por “nuk kishte pasur dyshime” (kohet e foljes), sepse nuk është se Raskolnikov i po e lexonte tani letrën. Ai e kishte lexuar atë pak më parë dhe prandaj kemi kohë të tjera të foljeve: “сомнений в нём не было ни на минуту, даже в то время, как он читал письмо”, pra “dyshime në të nuk kishte për asnjë çast, madje as edhe në kohën kur ai e pat lexuar letrën.” Pra, mos iu largo tekstit, përkthe dhe kuptimi del vetë, se jemi duke përkthyer dhe jo duke komentuar a perifrazuar. Vijon: “Kjo gjë duket sheshit, bën mu...” S’e ka fare këtë “bën mu”, pse e shton?! Pastaj “duke u gëzuar me dashakeqësi për vendimin e tij.” Nuk është kështu, por “... duke u ngazëlluar si i tërbuar që përpara për suksesin e vendimit te tij.” Pra shton fjalë, kur nuk duhet dhe, nga ana tjetër, lë fjalë pa përkthyer. Në këtë paragraf (f.49) dhe në paragrafin vijues (f.50) kemi disa fjalë të theksuara, në kursiv, por që janë lënë pa u nënvizuar, si “shumë gjëra (много-то), “tani” (уже), tri herë pa u nënvizuar “duket” (кажется) dhe kllapat që duhen te fjalët “siç shkruan mamaja” nuk i vë, kurse kllapa e hapur te fjalët “që tani e ka kapitalin e vet” duhej të mbylleshin te fjala “frymëzuese”. Pastaj nuk duhej “më mikluese”, por “më solide” (солиднее). Në këtë paragraf gjejmë “si rinia e sotme” dhe madje në thonjëza, që nuk janë në tekst. Një paragraf më poshtë e njëjta shprehje përkthehet “mendimet e tij të përparuara” dhe e vë në thonjëza, sepse këtu është në thonjëza, mirëpo ngaqë kemi të bëjmë më të njëjtën gjë (новейших поколений), duhej përkthyer njëlloj në të dyja rastet “brezat më të rinj”, se kështu e ka dhe kështu i duhet ta këtë autori. Nuk ka këtu “si rinia e sotme” apo “mendimet e tij të përparuara”. Po në këtë paragraf fjalinë “И эта Дунечка за это же кажется за муж идёт!” e lë fare pa përkthyer, që do të thotë: “Dhe kjo Dunjecka pikërisht për këtë duket se do të martohet!”. Në paragrafin më poshtë (f.50) gjejmë: “Mendoj se kështu duhet të ketë qenë...” Ku e ka këtë “Mendoj”?! Kjo formë të shprehuri ndoshta nuk përdoret asnjëherë nga autori ne roman. Aty është: “Вероятно, оно так отчасти и было”, pra “Ndoshta ajo pjesërisht kështu dhe ka qenë”. Më tutje gjejmë “...ka të ngjarë, ta vriste pa iu dridhur dora.” Përkthyesja shton “pa iu dridhur dora”, se kështu i duket mirë asaj, por autori nuk e ka fare këtë. Ai thotë: “он, кажется, убил бы его!” dhe ka pikëçuditje në fund. Pra “ai, ndoshta, do ta kishte vvarë atë!”

F.64: “Ai pa një ëndërr të frikshme. Pa një ëndërr sikur ishte në qytetin e tij të lindjes dhe ishte ende fëmijë 7 vjeçar.” Vijon përkthyesja me perifrazime dhe mosdhënien me saktësi të asaj që thotë autori. Pra, e lirë, siç e kupton ajo. Këtu autori nuk thotë “pa një ëndërr sikur ishte në qytetin e tij të lindjes”, por “Приснилось ему его детство”, pra “pa një ëndërr fëmijërinë e tij.” Vijon: “ dhe ishte ende fëmijë 7 vjeçar.” Kjo thuhet një fjali më poshtë. Me ç’të drejtë i shkrin fjalitë me njëra-tjetrën, i bashkon ato?! Në fakt është:



“Приснилось ему его детство, ещё в их городке.” Këtë duhej të përkthente, pra “Pa në ëndërr fëmijërinë e tij, kur jetonte akoma në qytetthin e tij të lindjes.” Pastaj, pas pikës vjen fjalia “Он лет семи...” , pra pikërisht këtu thuhet mosha. Së pari, duhej me vizë në mes “ 7-vjeçar”, së dyti, duhej shprehur me shkronja dhe jo me shifra “shtatëvjeçar” dhe, së treti, në tekst thuhet “Он лет семи”, pra autori nuk ka thënë shtatë vjeç, por afërsisht shtatë vjeç. Vijon pak më tutje: “пërreth s’kishte asnjë pemë...”, jo, nuk është thjesht “pemë”, por “ветла”, që është shelg, një lloj shelgu. Vijon “Disa hapa nga kopshti i fundit i qytetit (përkthyesja ka ngatërruar këtu oropod-kopsht me за городом - jashtë qytetit, pra në tekst është oropod-kopsht), ishte një tavernë, një tavernë e madhe, e cila gjithnjë i bënte një përshtypje jashtëzakonisht të pakëndshme (këtë e harron fare) dhe madje i ngjallte frikë, kur kalonte pranë saj, tek shëtiste me të atin.”

F.73-74: “Kohët e fundit Raskolnikov ishte bërë ca bestyt (duhej bestytë). Këtu ka pikë, kurse përkthyesja e heq pikën dhe vijon. Mirëpo nuk i del e lidhur mirë fjalia, pasi në origjinal thuhet pas pikës: “Следы суеверия оставались в нём ещё долго спустя, почти неизгладимо.” Pra “Gjurmët e bestytnisë do të mbeteshin edhe për një kohë të gjatë tek ai, thuajse në mënyrë të pashlyeshme.” Vijimi në përkthim, pas presjes, nuk shkon, se në fjalinë pararendëse nuk përmenden gjurmë. Lidhja bëhet me “bestytë”, pra “gjurmët e bestytnisë.” Pastaj thotë “do të mbeteshin gjatë ose për një kohë të gjatë (долго) dhe nuk thotë “për gjithë jetën”. Dhe më tej: “...i kishte folur Raskolnikovit për fajdexheshën Aliona Ivanovna.” Nuk është “fajdexheshën”, por “plakën” (старухи). Prapë e përsërit “Për një farë (kjo “një farë” duhet bashkë “njëfarë”) kohe (në fakt është për shumë kohë, për një kohë të gjatë (долго) Raskolnikov i nuk shkoi te fajdexhesha...” Nuk thuhet në origjinal te fajdexhesha, por “долго он не ходил к ней”, pra “ai për një kohë të gjatë nuk shkonte (dhe jo “nuk shkoi”) tek ajo” dhe s’është nevoja të na thuhet “fajdexhesha”, sepse ne e dimë tashmë që plaka merrej me fajde. Vijon: “Një muaj e gjysmë më pas atij iu kujtua fajdexhesha...” Prapë “fajdexhesha”. Ç’do këtu fajdexhesha?! Në tekst thuhet thjesht “iu kujtua adresa” dhe nënkuptohet fajdexhesha, se për adresën është folur pak më parë. Më tej: “...i zënë në mendime, që s’po e linin të qetë...” Ku janë këto? Në origjinal thjesht thuhet “задумался” (u zhyt në mendime) dhe ka pikë, të cilën përkthyesja nuk e vë, por vazhdon. E ndryshon fjalinë. Nuk thuhet në tekst “tamam si zogu që çukit vezën për të dalë...” Në origjinal është thënë : “Një mendim i çuditshëm po shfaqej në kokën e tij, si zogu i vogël që del nga veza (nuk ka “çukit”), dhe e kishte tërhequr shumë, jashtë mase atë”.

F.194: “Raskolnikov i eci drejt urës N.” Është: “...drejt urës ...skij”, që është ura Voznjesenskij në kanalin Jekatjerininskij dhe nuk është ura N. Po në këtë faqe: “...ndihej aq i këputur, sa mezi u zvarrit deri këtu.” Nuk është “u zvarrit”, por “arriti” (добрался). Pastaj: “U përkul mbi parmakët e urës. Rrezet e përflakta të diellit, që po perëndonte, i jepnin ujit të lumit ca refleksë ngjyrë roze. Në ujë reflektoheshin dhe një grumbull ndërtesash, që shquheshin turbull në mugëtirën e mbrëmjes. Ngriti sytë dhe pa diku në largësi, në bregun e majtë të lumit, një dritare, që përflakej në rrezet e kuqe të diellit.” Përkthimi i këtij pasazhi tregon shumë për mënyrën se si përkthen përkthyesja. Ky është një pasazh i tërë, kurse përkthyesja e ndërpret tri herë me pika dhe përkthen siç e kupton ajo, në mënyrë shpjegimore. Në fakt autori jep një frazë të pashkëputur përshkrimore: “Pasi u përkul mbi ujë, mekanikisht shikonte refleksin e fundit, rozë, të perëndimit, vargun e shtëpive që po errësoheshin në dendësimin e muzgut, një dritare të largët, diku në një papafingo, mbi bregun e majtë, që ndritte si të ishte e përflakur nga rrezja e fundit e diellit që e kishte goditur për një çast, shihte ujin gjithnjë e më të errët të kanalit dhe dukej sikur e vrojtonte atë me vëmendje.” Këtë ka thënë autori. Duke e ndërprerë rrjedhën e frazes me pika dhe duke e komentuar përshkrimin

e bërë nga autori, humbet bukuria e këtij përshkrimi. Pastaj ndryshon edhe kuptimi i frazës, sepse nuk është se këtu thuhet “Rrezet e përflakta etj.etj.” në përgjithësi, por në pasazh është dhënë si i shikon Raskolnikov i me sytë e tij ato çaste të perëndimit të diellit mbi urën Voznjesenskij në kanalin Jekatjerininskij. Rrjedhimisht deri diku del që ndryshe është shprehur autori dhe ndryshe e gjejmë në përkthim. Duke qenë se ka prirje të komentojë, lë edhe fjalë pa përkthyer që, natyrisht, shprehin nuanca të caktuara në kontekstin e dhënë, si “mekanikisht” (машинально), “papafingo” (мансарде) dhe, nga ana tjetër, shton fjalë: “Ia nguli përsëri shikimin valëzave të ujit.” Ku është thënë kjo më vete kështu?! Pastaj aty s’përmendet asnjëherë fjala “lumë”, në një kohë që në përkthim e gjejmë të përmendet dy herë. Është përmendur vetëm një herë kanali në fund të pasazhit, ku autori ka parasysh kanalin Jekatjerininskij. Në përkthim hasim “Në ujë reflektoheshin dhe një grumbull ndërtesash...” dhe “Ngriti sytë dhe pa diku

në largësi...” Ku janë të shprehura këto në origjinal?! Pastaj është harruar “rrezja e fundit e diellit”?! Aty nuk ka “rrezet e kuqe të diellit.”

F.275: “Gjatë bisedës Rasolnikovi ndiqte çdo lëvizje të Sonjës.” Në fakt është: “Ndërsa flisnin, Raskolnikovi e vëzhgonte atë me vëmendje.” (Kuptohet nga konteksti që është Sonja. Pra, mos vër emrin aty ku autori ka vënë për emrin, me mendimin se nuk do ta kuptojë lexuesi. Ti përkthe siç e ka autori dhe mos u merakos për atë nëse do ta kuptojë apo jo lexuesi. Gjithçka është e kuptueshme ashtu siç e ka shkruar autori, prandaj ndërhyrje e ndryshime të kësaj natyre nuk duheshin bërë në përkthim). Pak më tej shton: “që binte në sy”, ku e gjeti këtë?! Përkthyeses i duket se e thekson më mirë. S’është nevoja, lërja autorit theksimet dhe mostheksimet. Në këtë frazë janë lënë pa u përkthyer fjalitë “dhe edhe në gjithë figurën e saj” (да и во всей её фигуре), si dhe “dhe kjo nganjëherë manifestohet madje në mënyrë qesharake” (и это иногда даже смешно проявлялось).

F.413: “Nja dy sekonda, jo më shumë, pas derës vazhduan të shtyrat,” (Jo, është po ndodhte një luftë e vërtetë – происходила настоящая борьба, ose mund të thuhet përlëshje, kacafytje e vërtetë). Por nuk janë “të shtyrat”, ku e gjeti këtë?! Më poshtë po, kemi të bëjmë me shtyrje (оттолкнул). Pastaj thuhet: “...në zyrën e hetuesit hyri një person.” Jo, është “në zyrën e Porfirij Petroviçit” (ne e dimë që është hetuesi, por jepe siç e ka autori, me emër dhe mbiemër). Vazhdon: “Kishte sy të hapur e të ngathët, tepër të bardhë e të përhënur, si sy deleje.” E gjithë kjo fjali nuk është në tekstin origjinal të veprës dhe s’dihet si ka hyrë këtu. Pastaj sy “të përhënur” nuk shkon, sepse “i përhënur” do të thotë që ka shumë teka e trilla, që e ndërron mendjen orë e çast e nuk di as vetë se ç’dëshiron e ç’kërkon. Pra, fjalia e mësipërme nuk është fare në tekst, i cili vijon me fjalët “Ai shikonte drejt para vetes, por ama sikur nuk dallonte askënd (никого)”

F.425: “Dita që vijoi pas bisedës fatale me Dunjeçkën dhe Pulheria Aleksandroven ia kthjelloi mendjen Lluzhinit, tani filloi t’i shihte marrëdhëniet e tyre në një këndvështrim tjetër.” Ku e ka gjetur këtë fjalinë e fundit që nuk ekziston fare në origjinal?! Pastaj si mund të mendohet që autori të përdorë një mënyrë të tillë të shprehuri?! Në tekst thuhet: “Mëngjesi (jo dita), pas shpjegimit (jo “bisedës”, se është объяснение) fatal për Pjotër Petroviçin (dhe jo Lluzhinin) me Dunjeçkën dhe Pulheria Aleksandrovën, pati edhe për Pjotër Petroviçin efektin e një kthimi të menjëhershëm në realitet.” Kështu është shprehur autori.

Në f.463 thuhet: “Te dera zgjatën kokën dhe dy damat e pispillosura. (Nuk është pikë, por vijon fjalia) Nuk i kishin rezistuar dot kureshtjes të merrnin vesh, ç’po bëhej aty brenda.” Së pari, duhej “se ç’po bëhej aty brenda”, së dyti, mënyra e të thënit “Nuk i kishin rezistuar dot kureshtjes” nuk shkon bukur në shqip, por, veç kësaj, kjo nuk është fare në origjinal dhe është nga ato shtesat që bën përkthyesja, dhe, së treti, nuk është “të merrnin vesh, ç’po bëhej aty brenda”, por e gjithë periudha është: “Në derë, në atë çast, krahas Lebezjzatnikovit (këtë e harron fare), u dukën edhe disa persona të tjerë (edhe këtë e harron), ndër të cilët u duken edhe dy damat e ardhura ose mysafire (jo “e pispillosura”).

F.629: “Jetonte me veten dhe brenda vetes së tij (ç’do të thotë kjo?) ndiente krupë të shihte përreth.” Vazhdon përkthyesja me komentim. Në origjinal është: “Jetonte, si me shikimin poshtë: (këtu ka dy pika, që në përkthim nuk vihen) kishte neveri dhe s’duronte të shikonte drejt.” Pra, pse Raskolnikovi jeton me shikimin poshtë autori e shpjegon duke vënë dy pika, që përkthyesja i heq dhe kalon me presje. Dhe këtu nuk është fjala “të shihte përreth” (kuturu, si të vrojtonte natyrën në përgjithësi), por për të parë këdo në

sy, e ka për njerëzit. Më tej: “humnera...që ndodhej midis tij dhe gjithkujt tjetër...”, jo, është: “që ndodhej midis tij dhe atyre njerëzve (pra të burgosurve të tjerë)”. Nuk është “shokët e kampit i dukeshin si të ardhur nga një botë tjetër”, por “Dukej sikur ai dhe ata ishin të kombeve të ndryshme.” Më tej: “I dinte fare mirë (këtë “fare mirë” e shton përkthyesja nga ana e saj) dhe i kuptonte arsyet e kësaj ndarjeje, por më parë nuk kishte lejuar që kjo ndarje të ishte kaq e thellë.” Jo, është: “por më parë nuk kishte lejuar kurrë (këtë “kurrë” e harron) që këto arsye (shkaqe dhe jo “ndarje”) të ishin me të vërtetë (edhe këtë “me të vërtetë” e harron) kaq të thella dhe të forta (сильны)”. Pra autori nuk i drejtohet “ndarjes”, por arsyeve, shkaqeve. Vazhdon përkthimi: “Në kamp kishte edhe polakë, edhe të dënuar politikë.” Përkthyesja nuk e ka kuptuar si duhet, sepse është: “Në burg (dhe jo në kamp) kishte edhe disa polakë të internuar për krime politike.” Pra, nuk është se kishte edhe polakë, edhe të dënuar politikë. Vijon paragrafi: “Ata e mbanin veten më të madh, i quanin



të tjerët injorantë dhe i përçmonin”. Jo, është: “Ata thjesht i konsideronin gjithë këta njerëz injorantë e të pagdhendur (jo si thotë përkthyesja “e mbanin veten më të madh”) dhe me kryelartësi i përbuznin ata” dhe mbyllet paragrafi me fjalët: “Kishte edhe rusë, që i përbuznin të tjerët: ishte një ish oficer (duhej me vizë në mes ish-oficer) dhe dy seminaristë. Raskolnikovi e kuptonte, se ata e kishin gabim dhe nuk pajtohej me qëndrimin e tyre.” Në origjinal është thjesht: “Raskolnikovi e kuptonte mirë edhe gabimin e tyre.” Pra gjithë këtë tiradë “nuk pajtohej me qëndrimin e tyre” e shton përkthyesja nga xhepi i saj, se kështu i është dukur asaj e arsyeshme.


Lind pyetja: po redaktori ku ishte, që të bënte një konfrontim skrupuloz të veprës origjinale me përkthimin? Me sa duket konfrontimi ka qenë formal, “sa për të kaluar radhën”, se, veç këtyre pasaktësive, nuk kishte pse të kalonin edhe disa pasaktësi të karakterit gjuhësor dhe lapsuse si ato

që vijnë.

Qysh në fillim, kur përmendet titulli origjinal i veprës, hasim “Преступление и наказание”, kur duhej të ishte “наказание”. Kjo edhe në fund fare, kur jepet titulli origjinal me shkronja shqipe “Prestuplenie i nakazani”, kur duhej “nakazanie”. Pastaj mbiemri i shkrimtarit është Dostojevskij dhe jo Dostojevski. Në f.8,20,73,87 “nga që” duhej shkruar bashkë “ngaqë”, si lidhëz që është. Çuditërisht në f.76, 628 dhe 634 shkruhet mirë “ngaqë”. Në f.8 “kishin patur” dhe në f.626 “kishte patur”, kur duhej “pasur”, kurse një faqe më poshtë (627) është në rregull “pasur”. Në f.10 “Shërbenin tre-katër roje pallati.” Duhej “roja”, sepse kemi të bëjmë me rojtarët, pra rojë-a dhe shumë roja,rojat, kurse roj, roji është luzma e bletës që ka për shumë roje, rojet. Në f.11 “...kam qenë këtu tek ju...”, f.14 “mbaheshin tek njëri-tjetri” duhej “te”, në të dyja rastet, kurse në f. 12 “te këto vejushet”, f.13 “tek agjendari” dhe f.14 “u nis për të plaka”përdorimi i parafjalës është në rregull. Pra trajta “te” përdoret

zakonisht kur fjala ndjekëse nis me bashkëtingëllore, kurse “tek”, kur fjala ndjekëse nis me zanore. Në f.11 “pa ia ndarë shikimin pyetës fytyrës së tij” Absurditet, sepse po the “pa ia ndarë shikimin pyetës”, s’është nevoja të shtosh “fytyrës së tij”, që është e tepërt. Në f.13 “s’mund ta le për fare” dhe në f.460 “...jam gati t’ju le dhe pak kohë”, duhej “lë”. Në f. 16: “...po ndjente një nevojë të brendshme” duhej “ndiente”. Po në këtë faqe: “...dhe ai trishtimi i zymtë një mujor” duhej bashkë “njëmujor”. Po në f.16: “...djali e ndërmerdi disa herë...” Nuk ekziston folja “ndërmend”. Kemi vetëm ndërmend,i, pra si emër (krahinore), të menduarit për dikë, p.sh. Më ra ndërmendi i tij (m’u kujtua ai), si dhe foljen “ndërmendem” (vij në vete pasi kam humbur ndjenjat). Në këtë rast duhej thjesht “e kujtoi, e solli ndër mend...”. Në f.18 “ish student”, f.64 “7 vjeçar”, f.358 “herë herë”, f.430 “ish kujdestari”, f.631 “njëri tjetrin” dhe “shoku shokun”, “dita ditës” duheshin të gjitha më vizënë mes, por gjejmë edhe të kundërtën, pra vihet viza në mes, kur ajo nuk duhet, si në f.327 “së-dyti” dhe në f.461 “së-pari”. Në f.21 “fletë lavdërimi” duhej bashkë “fletëlavdërimi”. Në f.21 “...dhe personaliteteve të tjerë” duhej “të tjera”, sepse është rasti i disa emrave mashkullorë që në numrin shumë kërkojnë që mbiemrat përcaktues të tyre të vihen në trajtën e gjinisë femërore (artet e bukura, qytetet e mëdha). Në f.22 “Se s’kishte nga ja mbante”, duhej “t’ia mbante”. Në f.74 “mjaftonte t’ja vonoje një ditë paratë dhe t’a mbante për fare pengun.” Duhej “t’ia” vonoje dhe “ta’mbante... Në f.49 kllapa (që tani e ka kapitalin e tij) duhej të mbyllej pas fjalëve mikluese, frymëzuese. Po në këtë faqe fjalët “siç shkruan mamaja” janë në kllapa, por janë harruar ato. Pastaj “rinia e sotme” po në f.49 nuk është në thonjëza. Në f.50 “Zemërimi po i shtohet...” në origjinal nuk është kryeradhë dhe,

e kundërta, në f. 628 “E mundonte gjithashtu mendimi” është kryeradhë. Në f. 78, 88, 459, 460 “një fare” duhej shkruar bashkë, si përemër që është. Në f.80, 627 gjejmë trajtën “kish” të foljes, në një kohë që duhej përdorur trajta e plotë “kishte”, pra jo “kish pasur” e “kish bërë”, por “kishte pasur” dhe “kishte bërë”, sepse trajta e shkurtuar përdoret për arsye kryesisht të ritmit të ligjëritimit, për çka s’ishte nevoja në kontekstet ku janë përdorur këto trajta të shkurtuara të foljes. Në f.81: “...për të bërë një dorë thashetheme”, do të ishte më e saktë “për t’u marrë pak me thashetheme.” Në f.359 “...po thoshte një mendim të fshehtë, që e ishte ushqyer e rritur brenda vetes...”, duhej “që e kishte ushqyer”. Në f.626 “duhet të pajtohej” e saktë është “duhej të pajtohej”. Në f.629 “...deshi t’i hidhej dha ta masakronte.” Duhej “dhe” ta masakronte. Në f.634 “...do t’i fliste pafund për ungjillin”. Këtu është ndajfolje dhe duhej veç “pa fund”. Po të jetë mbiemër, shkruhet bashkë i, e pafund.



WILLIAM FAULKNER

Një fjalë për shkrimtarët e rinj

Dy vjet më parë Presidenti Eisenhower konceptoi një plan të mbështetur në një ide e cila në thelb është e mirë. Ideja ishte se rrethanat botërore, dilemat universale të njerëzimit në këtë kohë, janë ato që janë, thjesht dhe vetëm sepse burra dhe gra, individë të racave, gjuhëve dhe kushteve të ndryshme shoqërore s'mund t'i diskutojnë me njëri-tjetrin këto probleme dhe dilema që janë më së shumti të tyre, por duhet të përpiqen të bëjnë vetëm përmes organizatave zyrtare të qeverive të tyre kundërshtarë dhe siç duket të papajtueshme.

Kjo do të thotë, që individëve në të gjitha sferat e jetës duhet t'u jepet mundësia të flasin me individët në kampin e kundërt kudo në tokë - punëtori me punëtorin, shkencëtari me shkencëtarin, mjekët, avokatët, tregtarët, bankierët dhe artistët me kolegët e tyre që kanë pikëpamje të kundërta, kudo.

Agjë të gabuar s'ka tek kjo ide. Padyshim që asnjë artist - piktor, muzikant, skulptor, arkitekt, shkrimtar - s'do ta kundërshtonte sepse kjo - përpjekja e njeriut për të komunikuar me njeriun pavarësisht nga raca, ngjyra ose gjendja shoqërore - është pikërisht ajo që çdo artist është rrekur ta bëjë tashmë gjatë gjithë jetës, dhe do të vazhdojë ta bëjë derisa të marrë frymë.

Ajo çfarë e ka penguar këtë shenjohe nga frazeologjia e konceptit të vetë Presidentit: punëtor me punëtor, artist me artist, bankier me bankier, manjat me manjat. Çfarë e ka penguar këtë për

mendimin tim ishte një e keqe e qenësishme tek vetë kultura jonë; një cilësi e keqe e qenësishme (dhe mbase e domosdoshme edhe pse s'e besoj këtë të fundit) në kulturën e çdo vendi të aftë të durojë dhe mbijetojë gjatë kësaj periudhe të historisë. Ky është besimi mistik, gati fetar, që njeriu si individ s'mund të flasë me njeriun tjetër si individ, sepse individ s'mund të ekzistojë më. Një besim se s'ka më një vend ku individ mund t'i flasë me qetësi inditvidit tjetër për gjëra të tilla të thjeshta si ndershmëria me veten dhe përgjegjësia ndaj të tjerëve, mbrojtja e të dobëve, dhembshuria dhe keqardhja për të gjithë, sepse gjëra të tilla individuale si ndershmëria, keqardhja, përgjegjësia dhe dhembshuria s'ekzistojnë më dhe vetë njeriu mund të shpresojë të vazhdojë vetëm po hoqi dorë dhe mohoi individualitetin duke u bërë pjesë e një grupi të veçuar në mënyrë arbitrare, dhe të organizuar si regjim, i cili pozicionohet kundër një grupi tjetër të veçuar në mënyrë arbitrare, i organizuar si regjim, të dy duke mbushur të njëjtën atmosferë dhe në të njëjtën kohë me abstragime të dykuptimshme si "demokraci e popujve", "të drejtat e pakicave", "drejtësi e barabartë" dhe "mirëqenie sociale" - të gjitha sinonimet që heqin turpin nga papërgjegjësia duke mos ftuar por madje duke i detyruar të gjithë të bëhen pjesë e saj.

Pra, në këtë rast - dua të them se ashtu si popullit - edhe artistit, i cili tashmë e ka kaluar jetën duke u përpjekur t'u kumtoj për njeriun - problemet

dhe pasionet e zemrës njerëzore, si të mbijetojmë ose gjithsesi t'i durojmë ato, i është kërkuar nga Presidenti i vendit për të pohuar atë mitologji të cilës ia ka kushtuar tashmë jetën duke e mohuar: mitologjia se një njeri i vetëm s'është asgjë, dhe mund të ketë peshë dhe thelb vetëm kur organizohet brenda anonimatit të një grupi ku ai ia dorëzon shpirtin e tij individual duke u kthyer në numër.

Do të ishte vërtetë e trishtueshme nëse vetëm në momente të tilla si kjo - dua të them, pranimi zyrtar nga vendi të cilit i përket i vlerës së përkushtimit jetësor të artistit - artistit t'i duhej të kalonte me të gjitha energjitë e tij në atë që mund të quhet gati një vullnet universal për organizim ushtarak, një vullnet universal për të zhdukur njerëzoren nga njeriu edhe në masën e çlirimit të tij jo vetëm nga përgjegjësia morale, por edhe nga dhimbja fizike dhe vdekshmëria duke e shndërruar atë individualisht në çdokënd tjetër, s'ka rëndësi në cilin, për sa kohë që është zhdukur si pjesë e njërit prej tyre, duke u bërë pjesë e një grupi të njohur kombëtar ekonomik nga profesioni, tregtia ose profesioni ose në nivelin e tatimit mbi të ardhurat ose, nëse s'ofron asgjë tjetër, duke u kthyer në numër në një listë të ndërmarrjeve financiare. Tragjedia e tij është se sot ai duhet ta luftojë këtë trysni, të humb një pjesë të vetes, dhe nëse është artist, i duhet një forcë e shumë e madhe individuale kundër këtij vullneti universal për ta fshirë humanitetin e tij individual, që të jetë artist.

Dhe kjo na shpie më në fund tek ideja që dua të sugjeroj, e cila më duket se është një dilemë që e kanë të gjithë shkrimtarët e rinj sot.

Mendoj se ndoshta të gjithë shkrimtarët, ndërsa janë “të nxehtë”, duke punuar me shpejtësinë më të madhe pasi ndiejnë nevojën e jashtëzakonshme për të thënë diçka, s’i lexojnë shkrimtarët më të rinj, ata që shkruajnë më pas, ndoshta për të njëjtën arsye që vrapuesi i garave të shpejta apo të gjata s’ka kohë të interesohet se kush është pas tij apo edhe edhe ngjitur me të, por vetëm të shoh kë ka përpara. Kjo ishte e vërtetë në rastin tim të paktën, kështu që kishte një zbrazëti prej rreth njëzet e pesë vjetësh gjatë së cilës s’kisha pothuajse asnjë njohuri për letërsinë bashkëkohore.

Kështu, kur pak kohë më parë fillova të lexoja letërsinë që shkruhet tani, e bëra jo vetëm me mosdije, por edhe një lloj pafajësie, freskie, atë që mund ta quani pikëpamje dhe interes të dëlirë, pa paramendime. Sidoqoftë, përshtypja që mora nga historia e parë që lexova më është përsëritur kaq shpesh qysh atëherë, sa do ta paraqes si përgjithësim.


Kjo do të thotë se shkrimtari i ri i sotëm, për shkak të gjendjes së tashme të kulturës sonë të cilën u përpoqa ta përshkruaj, është i detyruar të punojë në një lloj zbrazëtie të racës njerëzore. Personazhet e tij nuk jetojnë, marrin frymë, luftojnë, në atë sprovë dhe zemëratë të humanitetit të thjeshtë, si të paraardhësve që ishin mjeshtrat nga të cilët mësuam zanatin tonë: Dickens, Fielding, Thackeray, Conrad, Twain, Smollett, Hawthorne, Melville, James; ata kanë legjione personazhesh që jo vetëm u mëkuan, por edhe u rritën në gjirin e sprovës dhe zemëratës së qenieve të thjeshta njerëzore, ekzistenca e të cilëve ishte pohim i një optimizmi të pashërueshëm dhe të paepur – të burrave dhe grave si ata vetë, të kuptueshëm dhe të rrokshëm edhe kur ishin antipatik, madje edhe në çastin kur ata po vrisnin, plaçkitnin ose po tradhtonin, pasi kishin të njëjtat epshe të thjeshta njerëzore, shpresë dhe frikë të pandërlikuar nga organizimi shoqëror si regjiment ushtarak apo detyrimi i grupit - sprovë dhe zemëratë e njerëzores prej të cilës mund të gjenin shtegdalje jo vetëm të pafrikësuar por edhe me kënaqësi dhe pa kërcënimin e të lënduarit pasi më e keqja që mund t’u ndodhte do të ishte një kokë e përplasur me një tjetër kokë njeriu, një bërri ose një gju që të lëndon por sidoqoftë ishte gju ose bërri tjetër njeriu që e bënte këtë – sprovë dhe zemëratë e njerëzimit që pranoi dhe besoi dhe funksionoi, jo sipas pikëpamjeve, por sipas parimeve morale; ku e vërteta nuk ishte aty ku ti po qëndroje, nga po e shihje, por ishte një cilësi ose diçka e pandryshueshme që mund dhe të rrëzonte përtokë nëse s’e pranoje ose të paktën ta respektoje.

Ndërsa sot personazhet e shkrimtarit të ri janë të detyruar të mos funksionojnë me individualitet, por në izolim, s’ndjekin shoqërinë e pafund të anktheve dhe shpresave të të gjitha zemrave njerëzore në botë të mbrujtura me disa të vërteta të thjeshta, të kuptueshme dhe parime morale, por ekzistojnë vetëm brenda një zbrazëtie faktesh të cilat ai s’i zgjodhi dhe s’mund t’i përballojë dhe prej të cilave s’mund të arratiset njësoj si insekti brenda një kupe të përmbysur.

Më lejoni ta përsëris: s’i kam lexuar të gjitha veprat që brezi i sotëm ka shkruar; ende s’kam pasur kohë. Kështu që duhet të flas vetëm për ato vepra që i njoh. Tani po mendoj për atë që vlerësoj më të mirin: *Rojë në thekërishten buzë gremenës*, mbase sepse ky roman shpreh plotësisht atë që po rrekem të them: një i ri, ati i asaj që do, duhet që një ditë të jetë burrë, më inteligjent se disa dhe më i ndjeshëm se shumica, (ai as s’do ta quante instiktivisht sepse s’e dinte që e zotëronte) një burrë i cili ngaqë Zoti mbase e kishte vendosur atje, e donte burrin dhe dëshironte të ishte pjesë e njerëzimit, një burrë i cili u përpoq t’i bashkohej racës njerëzore dhe



dështoi. Për mua, tragjedia e tij është jo se ishte, siç mbase mendonte, jo i fortë ose trim sa duhej apo se s’e meritonte të pranohej si pjesë e humanitetit. Tragjedia e tij ishte se kur u përpoq të hynte në racën njerëzore, s’kishte asnjë racë njerëzore atje. S’kishte asgjë për të përveç gumëzhimës shurdhuese dhe të pandryshueshme brenda mureve prej qelqi të kupës së tij derisa të hiqte dorë ose të shkatërrohej vetë nga gumëzhitja shurdhuese, shkatërruese brenda tij. Sigurisht, mendja të shkon menjëherë tek Huck Finn, një tjetër i ri tashmë baba i asaj që një ditë së shpejti do të bëhet burrë. Por në rastin e Huck-ut gjithçka ndaj së cilës ai duhej të luftonte ishte përmasa e tij e vogël, të cilën koha do t’ia gjente ilaçin; me kalimin e kohës do të rritet si çdo njeri me të cilin duhej të përballej; dhe madje ashtu siç ishte, gjithçka që bota e të rriturve mund të bënte për ta dëmtuar atë ishte t’ia tërhiqte pak hundën; humaniteti, raca njerëzore,



po e pranonte tashmë dhe do ta pranonte; gjithçka që duhej të bënte ishte vetëm të rritej në të.

Kjo është dilema e shkrimtarit të ri siç e shoh unë. Jo vetëm e tij, por të gjitha problemet tona, janë për të shpëtuar njerëzimin që të mos çshpirtërohet ashtu si tredhet hamshori, derri i egër apo demi; për ta shpëtuar individin nga anonimatit para se të jetë tepër vonë dhe njerëzorja të jetë zhdukur nga kafsha e quajtur njeri. E kush mund ta shpëtojë njerëzoren e njeriut më mirë sesa shkrimtari, poeti, artisti, pasi kush më shumë duhet t’i frikësohet humbjes së tij sepse njerëzorja e njeriut është lëngu i jetës së artistit.

Fjalim i mbajtur në Universitetin e Virxhinias,
1958

Përktheu: Granit Zela



ABDULLAH ZENELI

— POEZI —

RABINI IM

Me parathënie nga
ROLAND GJOZA



*"Poezia e Abdullah Zenelit e librit 'Rabini im' Poezia
e Abdullah Zenelit e librit 'Rabini im' Poezia e
Abdullah Zenelit e librit 'Rabini im'
Poezia e Abdullah."*

ROLAND GJOZA

BUZUKU